



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Program i Integruar Master i Shkencave në: “Drejtësi”
Universiteti “Epoka”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Enkeleda Oldashi

Prof.Asoc. Jola Bode

Tetor / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Program i Integruar Master i Shkencave në “Drejtësi”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Epoka”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Drejtësisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave (PI) në Drejtësi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 412, datë 18.09.2017.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 Vite/ 10 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip dhe anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13 PAE / 9 PAK Ngarkesa mësimore 63 % PAE - 37 % PAK
18	Numri i studentëve:	Viti 2018-2019 17 studentë Viti 2019-2020 8 studentë Viti 2020-2021 18 studentë Viti 2021-2022 18 studentë Viti 2022-2023 20 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Epoka” është Institucion i Arsimit të Lartë, i cili ka filluar aktivitetin e tij akademik dhe shkencor në vitin 2008 në bazë të VKM Nr.281, datë 12.03.2008. Universiteti “Epoka” ka në strukturën e tij akademike tre njësi kryesore:

1. Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative;
2. **Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale;**
3. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë;


Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale është një ndër tre njësitë kryesore dhe ka në përbërjen e tij tre njësi bazë:

1. Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
2. **Departamentin e Drejtësisë;**
3. Qendra për Studimeve Evropiane;

Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të Studimeve Master i Shkencave në “Drejtësi” ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë (si njësi bazë), dhe synon të ofrojë dhe promovojë vlerat akademike dhe shkencore në fushën e drejtësië. Ky program studimi përmban 300 ECTS dhe është i organizuar në 5 (pesë) vite akademike (10 semestra), duke ofruar në fund të studimeve njohuri të bazë dhe të thelluara në fushën e të drejtës (publike, civile dhe penale). Ky nivel studimesh mundëson për të diplomuarit vijim të studimeve për në ciklin e tretë të studimeve ose studimeve në fushën profesionale si në: Magjistraturë, Noteri, Avokati si dhe punësim në tregun e punës si ekspert ligjorë apo punonjës në sektorin publik/privat.

Ky program studimi është miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit në Republikën e Shqipërisë, me nr.412, datë 19.09.2017.

Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të Studimeve Master i Shkencave në “Drejtësi” që ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë si një prej tre njësive bazë të Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, akreditohet për herë të parë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Ekspertët e jashtëm Prof.Asoc Enkelejda Olldashi dhe Prof. Asoc. Jola Bode u caktuan nga ASCAL si ekspertë të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) për vlerësimin e Programit të ntegruar të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi, cili zhvillohet në Fakultetin e Drejtësisë dhe të Shkencave Sociale të Universitetit Epoka. Gjatë gjithë procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, si dhe vizitën dy ditore në institucion, ekspertët e jashtëm u asistuan nga përfaqëuesja e ASCAL Majlinda Demirneli.

Ekspertët e jashtëm u njohën paraprakisht me dokumentacionin e dërguar nga Institucioni. Më tej, procedura vijoi me trajnimin pranë ASCAL mbi parimet dhe procedurat e procesit të vlerësimit, ndarjen e punës dhe dakortësimin e grupit mbi data e zhvillimit të vizitës në institucion.

Vizita në institucion u zhvillua në datat 06 dhe 07 Korrik në përputhje me axhendën e takimeve të koordinuar nga ASCAL me të cilën GVJ ishte i njohur paraprakisht. Gjatë vizitës dy ditore GVJ zhvilloi takime me Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, Përgjegjësin e Departamentit të Drejtësisë si dhe Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB). Me tej, takimet vijuan me stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm të angazhuar në këtë program studimi, përfaqësues të studentëve, përfaqësues të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe Sektorit të Burimeve Njerëzore.

Gjatë kësaj vizite GVJ realizoi vëzhgime të mjediseve dhe infrastrukturës në funksion të mbarëvajtjes së zhvillimit të procesit mësimor të këtij programi studimit. U zhvilluan vëzhgime pranë Sekretarisë Mësimore, bibliotekës, auditorëve si dhe mjediseve të zhvillimit të veprimtarive mbështetëse ndaj studentëve. Gjatë vizitës në institucion, GVJ kërkoi dokumentacion shtesë i cili u vu në dispozicion në sistemin e ASCAL dedikuar procedurës lidhur me këtë program studimi.

GVJ pasi diskutoi informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion si dhe shqyrtoi dhe analizoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, hartoi Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ). Ky raport pasqyron vlerësimin e në lidhje me plotësimin e kitereve dhe standarteve që i referohen këtij program studimi bazuar në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL si dhe vizitës së realizuar në institucion.


Universiteti “EPOKA” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 13.09.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 235/20 Prot, datë 13.09.2023. Universiteti “EPOKA” më datë 21.09.2023, ka njoftuar nëpërmjet sistemit AMS “Komente në lidhje me Draft Raportin”, ku shprehin dakortësinë me gjetjet e nxjerra në raport, dhe marrjen e masave për përmbushjen e tyre. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Integruar të Cikit të Dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti “Epoka” është Institucion i Arsimit të Lartë, i cili ka filluar aktivitetin e tij akademik dhe shkencor në vitin 2008 në bazë të VKM Nr.281, datë 12.03.2008.</p> <p>Universiteti “Epoka” ka në strukturën e tij akademike tre njësi kryesore dhe ofron programe në të tre ciklet e studimit.</p> <p>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale është një ndër tre njësitë kryesore dhe ka në përbërjen e tij tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;2. Departamentin e Drejtësisë; (pranë të cilit ofrohet dhe Programi i Integruar i ciklit të dytë në “Drejtësi”);3. Qendra për Studimeve Evropiane; <p>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Drejtësi” i ofruar nga kjo IAL dhe në mënyrë më specifike nga Departamenti i Drejtësisë (si njësi bazë), synon të ofrojë dhe promovojë vlerat akademike në fushën përkatëse të studimeve. Ky program studimi është bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe në aktet bazë të brendshme të institucionit (Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme), të cilat synojnë të promovojnë dhe të nxisin studentët drejt përfuturit dhe aplikimit në praktikë të vlerave akademike dhe demokratike në shoqërinë shqiptare.</p> <p><i>Evidenca nr.1 “Statuti”;</i></p> <p><i>Evidenca nr.7 “Rregullorja e përgjithshme</i></p>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> <p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p> <p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë në “Drejtësi” ofrohet në përputhje të plotë me qëllimin dhe parimet bazë të institucionit, të cilat janë të sanksionuara në statutin, rregulloren e përgjithshme dhe në strategjinë e institucionit. Në bazë të këtyre akteve bazë të këtij institucioni janë ofruar dhe të gjitha programet e studimit, duke përfshirë dhe këtë program studimi.</p> <p>Strategjia bazë/kuadër e institucionit ka të mirëpërcaktuar prioritet e zhvillimit institucional dhe programeve të studimit, duke synuar të ofrojë për tregun e punës të diplomuar të formuar me normat etike dhe profesionale. Ky dokument është hartuar në bazë të disa shtyllave bazë të zhvillimit institucional, duke synuar në të njëjtën kohë dhe zhvillimin e interesit kombëtar në fushën e arsimit dhe shkencës.</p> <p>Ky program studimi ka fushë të përcaktuar studimore, e cila përputhet dhe me një nga fushat e njësive kryesore (Fakultetit të Drejtësië dhe Shkencave Sociale).</p> <p>Ky program studimi është pjesë e programeve të ofruara nga njësia kryesore dhe në mënyrë më specifike nga njësia bazë që është Departamenti i Drejtësië (bazuar në rregulloren përkatëse).</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i> <i>Evidenca nr.7;</i> <i>Evidenca nr.12 “Strategjia e institucionit”;</i> <i>Evidenca nr.13 “Rregullorja e programit të studimit”</i></p>			
<p>Kenkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë në “Drejtësi” ofrohet në përputhje të plotë me parimet bazë të institucionit (të sanksionuara në statutin, rregulloren e përgjithshme dhe në strategjinë bazë/kuadër të institucionit).</i></p> <p><i>Strategjia e institucionit ka të mirëpërcaktuara prioritet e zhvillimit institucional dhe programeve të studimit, duke synuar të ofrojë për tregun e punës të diplomuar të formuar me normat etike profesionale dhe në të njëjtën kohë në mbështetje të interesit kombëtar në fushën e arsimit dhe shkencës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë dhe mbështetet nga një staf akademik me përvojë në fushën e drejtësisë si dhe në një infrastrukturë të përshtatshme për studentët dhe stafin akademik.</p> <p>Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë pranë të cilit ofrohet ky program studimi, është një njësi akademike që zhvillon aktivitetin akademik dhe shkencor në fushën e të drejtës publike dhe private.</p> <p><i>Evidenca nr.6 “CVs të stafit akademik”;</i> <i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.76 “Informacion mbi infrastrukturën”</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë, i cili është një prej tre njësive bazë të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale në të cilin janë tre njësi bazë: Departamenti i Drejtësisë dhe Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Qëndëra e Studimeve Evropiane. Të tre njësitë bazë, si pjesë e njësisë kryesore, janë në funksion të programeve të studimit të ofruara dhe të këtij programi studimi.</p> <p>Institucioni ka aplikuar për kodifikimin e programeve të studimit, përfshirë dhe këtë program studimi (sipas korrespondencës me MAS, evidenca nr.100).</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i> <i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.20 “Skema e organizimit të institucionit”</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të</p>	<p>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë (njësia bazë), në të cilin fusha e përgjithshme dhe specifike e studimeve është ajo e drejtësisë.</p>



<p>njesisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Ky është një program studimi që ofrohet vetëm nga një prej njësive bazë të institucionit.</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i> <i>Evidenca nr.2 "Rregullorja e ciklit të dytë të studimeve";</i> <i>Evidenca nr.7; Evidenca nr.13</i></p>		
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>NA</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucioni mundëson për studentët që ndjekin studimet pranë këtij institucioni si dhe për të diplomuarit trajnime të vazhdueshme, në formën e leksioneve të hapura me pedagogë vendas dhe të huaj.</p> <p><i>Evidenca nr.25 "Lista e leksioneve me pedagogë të huaj";</i> <i>Evidenca nr.69 "Lista e marrëveshjeve";</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në "Drejtësi" i ofruar nga Departamenti i Drejtësisë (njësia bazë) ka fushë të përgjithshme dhe specifike të studimeve fushën e drejtësisë. Institucioni mundëson për studentët që ndjekin studimet pranë këtij institucioni dhe në këtë program studimi, trajnime të vazhdueshme, në formën e leksioneve të hapura me pedagogë vendas dhe të huaj në fushën e drejtësisë, në përputhje me fushën bazë dhe specifike të studimeve..</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit



të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në aktet bazë të institucionit janë të mirëpërcaktuara detyrat dhe funksionet e njësive akademike, ndihmës akademike dhe administrative. Njësitë përbërëse të Universitetit EPOKA bashkërendojnë punën ndërmjet tyre në funksion të procesit akademik dhe kërkimor-shkencor. Personeli akademik angazhohet dhe me detyra administrative, të cilat janë të lidhur me procesin akademik.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i> <i>Evidenca nr. 20 "Organograma e institucionit"</i></p>

<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p> <p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në nivel institucional janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe në fushën e arsimit si dhe marrëveshje me partnerë të tjerë brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëveshje janë dhe në kuadër të strategjisë së institucionit për ndërkombëtarizimit dhe partneritetit institucional.</p> <p>Marrëveshjet e bashkëpunimit janë në funksion të të gjitha programeve të studimit dhe në funksion të programit të integruar të studimeve në “Drejtësi”.</p> <p>Institucioni ka nënshkruar dhe është anëtar i një organizmi universitar ndërmjet univeristeteve evropiane në fushën e arsimit, i cili mbështetet në parimet Kombeve të Bashkuara (<i>sipas RVB-së, fq.16.</i>)</p> <p>Për realizimin e këtij program studimi dhe procesit akademik, marrëveshjet e bashkëpunimit janë dhe institucionet publike dhe private në vend. Këto marrëveshje mundësojnë zhvillimin e praktikave dhe bashkëpunimit institucional në ofrimin e eksperiencës akademike dhe shkencore në fushën e arsimit dhe të teknologjisë. Zhvillimi i praktikës profesionale, si një ndër lëndët në kurrikulën e programit të studimit, mundësohet edhe në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p><i>Gjithsesi, GVJ vlerëson dhe rekomandon që njësia bazë (Departamenti i Drejtësisë), duhet të lidhë marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave mësimore dhe shkëmbim të ekspertizës akademike dhe profesionale edhe me partnerë të tjerë në fushën e drejtësisë. Kjo do të mundësojë dhe një shkëmbim reciprociteti me institucionet publike dhe private, të cilat veprojnë dhe kontribuojnë në fushën e drejtësisë. Kjo do të shtonte gjithashtu dhe kontaktet institucionale dhe do ta lidhnin edhe më shumë këtë program studimi me tregun e punës.</i></p> <p><i>Evidenca nr.26 “Lista e marrëveshjeve të parteneritetit të jashtëm”;</i></p> <p><i>Evidenca nr.21 “Plani Strategjik për Ndërkombëtarizimin”;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 69 “Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të programit të studimit”</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë, si njësia bazë që ofron këtë program studimi, harton raportin vjetor të punës dhe veprimtarisë së kësaj njësie, në bazë të një formati të miratuar në nivel institucional.</p>



<p>përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p><i>GVJ rekomandon, që pjesë e këtij raporti duhet të jetë dhe vlerësimi mbi marrëveshjet e bashkëpunimit, të cilat janë në funksion të këtij programi studimi. Përfshirja në raportin vjetor të njësisë bazë të komponentit që lidhet me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit apo dhe mos realizimin e objektivave që synohen nga njësia në lidhje me këto marrëveshje do të ndihmonte departamentin në përmbushjen e objektivave akademike.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 74 “Raporti vjetor i departamentit për vitin 2021-2022”</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Institucioni ka lidhur në vijimësi marrëveshje bashkëpunimi, me institucione dhe partnerë brenda dhe jashtë, të cilët operojnë në fushën e arsimit. Në të njëjtën kohë, institucioni ka nënshkruar dhe është anëtar i një organizmi universitar që është ndërmjet univeristeteve evropiane në fushën e arsimit.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që departamenti përkatës (pranë të cilit ofrohet ky program studimi), duhet të bëjë pjesë të analizës vjetore dhe vlerësimin mbi marrëveshjet e bashkëpunimit; përfitimet apo dhe mos realizimin e objektivave që synohen në lidhje me këto marrëveshje bashkëpunimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>
--	-------------------------------------	------------------------------------	-------------------------------------	-----------------

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1



Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i Integruar i studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” është i organizuar në formën e krediteve ECTS në 5 (pesë) vite akademike me 300 ECTS.</p> <p>Ky program studimi zhvillohet në 10 (dhjetë) semestra akademike me numër të njëjtë kreditesh në cdo semestër (30 ECTS). Lëndët e në këtë program studimi janë të kategorizuara sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (kategorizimi A-E). Lëndët në këtë program studimi ofrohen në shqip dhe në anglisht, sipas përcaktimeve në rregulloren e programit dhe kurrikulën akademike përkatëse. Kategorizimi i lëndëve sipas përcaktimeve ligjore mundëson ofrimin e njohurive teorike (kryesisht të shpërndara në vitet e para akademike) dhe praktike (të programuara për tu ofruar në vitet e fundit të studimeve)</p> <p><i>Evidenca nr.4 “Kurrikula e programit të studimit”;</i> <i>Evidenca 5.1 & 5.2 “Programet e lëndëve”;</i> <i>Evidenca nr.7;</i> <i>Evidenca nr.93 “Tabela përmbledhëse”</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i Integruar i studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” është i fokusuar në fushën e së drejtës në tërësi (publike dhe private).</p> <p>Ky program studimi ka të përfshira lëndë të fokusuar në njohuri të mirëfillta teorike dhe praktike si dhe lëndë të formimit të përgjithshëm, të lidhura me fushën e së drejtës, p.sh: E Drejta Publike, Historia e institucioneve, E drejta Romake, Filozofia e së Drejtës , E Drejta Kushtetuese etj (lëndë që ofrojnë njohuri bazë teorike); E Drejta Civile, E drejta Penale, E Drejta e detyrimeve, E Drejta familjare etj (lëndë që ofrojnë njohuri teorike-praktike); Hyrje në Shkencat Politike, Shkrimi ligjor dhe metodat e arsytimit, Hyrje ne Ekonomi etj (lëndë që ofrojnë njohuri plotësuese mbështetëse në fushën e së drejtës)</p> <p>Pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi është dhe praktika mësimore/intership, e cila zhvillohet në vitin e pestë akademik (semestri i dhjetë), me 6 ECTS. Kjo lëndë mbështetet nga stafi</p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>akademik përmes realizimit të saj në mbikqyrjen e pedagogëve përgjegjës.</p> <p><i>Evidenca nr.4; Evidenca nr.5.1 & 5.2</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sipas dokumentit të propozimit për hapjen e programit të studimit dhe sipas rregullores së funksionit të programit të cilat u shqyrtuan nga GVJ, ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015.</p> <p>Universiteti Epoka nuk gëzon status të veçantë, pra kjo pjesë e këtij kriteri nuk zbatohet për këtë institucion.</p>

<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i Integruar i studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” është i ngjashëm në masën 70 % me programet e tjera të të njëjtit cikël studimi të ofruara nga universitetet publike dhe private në vend. Kjo përshtatje mundëson transferimin e studimeve të studentëve brenda vendit, por dhe jashtë vendit meqenëse lëndët janë të organizuara në bazë të krediteve të transferueshme evropiana ECTS.</p>			
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” si dhe programet e tjera të këtij institucioni janë në fazën e aplikimit për kodifikimin përkatës. Institucioni ka paraqitur dokumentacionin përkatës në lidhje me këtë aplikim.</p> <p><i>Evidenca nr. 100</i></p>			
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i Integruar i studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” në Universitetin Epoka nuk ofrohet në kuadrin e ndonjë bashkëpunimi të tillë pra ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Programi i Integruar i studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” është i organizuar dhe strukturuar në formën e krediteve ECTS, në 5 (pesë) vite akademike me 300 ECTS, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Lëndët janë të kategorizuara sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (kategorizimi A-E).</i></p> <p><i>Lëndët ofrohen në shqip dhe në anglisht, sipas përcaktimeve në rregulloren e programit dhe kurrikulën akademike përkatëse.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																							
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p> <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Sipas dokumentave, në 16/12/2021, me Vendimin nr. 54 të Bordit të Akreditimit, Universiteti Epoka është akredituar në nivel Institucional për 6 (gjashtë) vite akademike, duke përmbushur kërkesën ligjore për akreditim institucioni.</p> <p>Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit është Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale i cili, duke qenë i organizuar në 3 njësi bazë si më poshtë plotëson kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi, sipas të cilit një Fakultet organizohet në të paktën tre njësi përbërëse nga të cilat të paktën dy janë departamente.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Drejtësisë; 2. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marëdhënieve Ndërkombëtare; 3. Qendra për Studime Europiane; <p>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale në vitin akademik 2022-2023 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (25 pedagogë PAE) dhe 17 Personel Akademik me Kontratë, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë (<i>Annex Nr. 93-Tabela Permbledhese, tab 1.5</i>)</p> <table border="1" data-bbox="555 1220 1380 1563"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>12</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>9</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>25</td> <td>17</td> </tr> <tr> <td></td> <td colspan="2" style="text-align: center;">42</td> </tr> </tbody> </table> <p>Duke analizuar të dhënat në dosjen DVV rezulton se çdo njësi bazë e Fakultetit plotëson kriterin ligjor për sa i përket numrit dhe kualifikimit shkencor.</p> <p>Njësia bazë, Departamenti i Drejtësisë, përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:</p>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale		PAE	PAK	Prof.Dr	1	2	Prof.Asoc	3	2	Dr/PhD	12	9	Msc	9	4	Gjithsej	25	17		42	
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale																							
	PAE	PAK																						
Prof.Dr	1	2																						
Prof.Asoc	3	2																						
Dr/PhD	12	9																						
Msc	9	4																						
Gjithsej	25	17																						
	42																							

Tituj/ grada	2018-2019		2019-2020		2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	-	1	2	-	2	-	2	-	2
Prof. Asoc.	-	-	-	1	-	-	-	1	-	-
Dr./PhD.	3	4	4	4	6	2	7	5	8	8
Msc.	3	1	2	3	1	4	-	3	1	1
Totali	7	5	7	10	7	8	7	11	9	11

Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” ka si lëndë me 6 ECTS praktikën mësimore, e cila mbështetet dhe realizohet nga studentët në bazë të akteve të brendshme të miratuara ng institucioni.

Pranë këtij programi studimi angazhohet një pjesë e stafit akademik si dhe konsulenti akademik, i cili mundëson për studentët orjentimin për zgjedhjen dhe regjistrimin në semestrat përktës. Në funksion të përmbushjes së këtij programi studimi është i angazhuar dhe stafi administrativ dhe ndihmës akademik, si punonjësit e IT-së.

Për këtë program studimi është emëruar dhe një koordinator, i cili është staf administrativ pranë kësaj njësie akademike.

Evidenca nr. 13; Evidenca nr.20;

Evidenca nr.71; Evidenca nr.93/ tabela 6 & 7;

Evidenca nr.53 “Udhëzues për praktikën profesionale:

Evidenca nr.54 ‘Formularë për ushtrimin e praktikës profesionale’;

Evidenca nr.97 “Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit”

Konkluzione

Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:

Departamenti i Drejtësisë, i cili është një prej njësive bazë të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shlencave Sociale, pranë të cilit

	<i>ofrohet ky program studimi, përbëhet nga stafi akademik me më kohë të plotë (PAE) dhe me kohë të pjesshme (PAK), të cilët kanë kualifikimet e duhura akademike dhe profesionale, duke përmbyshur standartet e përcaktuara ligjore.</i>			
Shkalla e përmbyshjes së standardit		Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbyajtjen e programit të studimit.	<p>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, si njësia kryesore, pranë të cilit është dhe Departamenti i Drejtësisë, në të cilin ofrohet dhe Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi”, është i organizuar në aspektin stukturor akademik, në bazë të statutit dhe rregullores se përgjithshme të institucionit.</p> <p>Kjo njësi kryesore dhe njësia bazë kanë të mirëpërcaktuara në rregulloret përkatëse detyrat dhe funksionet. Njësitë (njësia kryesore dhe bazë) përgjegjëse për këtë program studimi kanë informacionin e nevojshëm akademik dhe administrativ.</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i> <i>Evidenca nr.7; Evidenca nr.13;</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” është bazuar në aktet e brendshme bazë të institucionit si dhe në aktet e brendshme, të cilat janë në funksion të këtij programi studimi. Kurrikula e programit të studimit është e organizuar në bazë të krediteve ECTS dhe orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditorit (orët individuale) për çdo lëndë.</p> <p>Lëndët në këtë program studimi janë kryesisht lëndë që zhvillohen vetëm në një semestër akademik, por ka dhe lëndë që janë të shtrira përgjatë dy semestrave akademike si p.sh:</p> <p>E Drejta Civile (I&II); E Drejta Penale (I&II); E Drejta e Detyrimeve (I&II); E Drejta Administrative (I&II).</p>

	<p>Programi i studimit përmban informacionin e duhur akademik/mësimor, sipas kritereve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidenca nr.4;</i></p> <p><i>Evidenca nr.13;</i></p> <p><i>Evidenca nr.78 "Udhëzuesi për studentët"</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Rregullorja e Programit të Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë në "Drejtësi" ka të përcaktuar kriteret e pranimit të studentëve, të transferimit të studimeve dhe ekujalentimit të tyre. Në këtë program studimi nuk ka studentë të transferuar nga ndonjë institucion tjetër arsimor (sipas minutave të takimit të GVJ në institucion).</p> <p>Kurrikula e këtij programi studimi ofron informacionin e plotë mbi lëndët, orët akademike dhe formën e shpërndarjes së tyre në formën e leksioneve dhe seminareve si dhe orët e punës individuale nga ana e studentëve, numrin e krediteve ECTS, vitin/semestrin akademik ku zhvillohet.</p> <p>Informacioni është në dispozicion të studentëve që në momentin e rregjistrimit të tyre dhe ofrohet në vijimësi nga struktura akademike dhe administrative e institucionit. Konsulenti akademik mundëson për studentët informacionin e nevojshëm mbi lëndët dhe rregjistrimin e tyre në cdo semestër.</p> <p><i>Evidenca nr.4;</i></p> <p><i>Evidenca nr.13;</i></p> <p><i>Evidenca nr.114 "Lista e konsulentëve akademik të këtij programi studimi"</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë për këtë program studimi, diskuton në mbledhjet e kësaj njësisë përmirësimin e programeve të lëndëve, në lidhje me literaturën që do të përdoret dhe temave që lidhen me aktualitetin (sipas minutave të takimit të GVJ në institucion). Ky është akreditimi i parë për këtë program studimi dhe njësi bazë nuk ka bërë ndryshime në kurrikulën përkatëse.</p> <p><i>Evidenca nr.13;</i></p> <p><i>Evidenca nr.4;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p>

	<p><i>Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” është bazuar në aktet e brendshme bazë të institucionit si dhe në aktet e brendshme, të cilat janë në funksion të këtij programi studimi dhe është e organizuar në bazë të krediteve ECTS me orët mësimore të përcaktuara (në auditor dhe jashtë auditorit/orët individuale) për çdo lëndë, sipas strukturës së përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Kurrikula është e strukturuar dhe ofron të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët (sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi), duke detajuar informacionin në formën e duhur akademiko-mësimore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e kurrikulës së programit të Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” është në përputhje të plotë me njohuritë që ofrohen përmes lëndëve që janë pjesë e këtij programi. Përmbajtja e kurrikulës së këtij programi studimi mundëson njohuri bazë dhe të thelluara në fushën e të drejtës publike dhe private dhe është në përputhje me qëllimin dhe objektivat e këtij programi, të cilat janë të parashikuara dhe në rregulloren e tij.</p> <p><i>Evidenca nr. 4;</i></p> <p><i>Evidenca nr.13;</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe</p>	<p>Të gjitha lëndët e këtij programi studimi kanë të përcaktuar: numrin e krediteve, shpërndarjen e orëve mësimore, formën e orëve mësimore (leksione/seminare), objektivat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, format e kontrollit të njohurive, komponentët e vlerësimit dhe shpërndarjen e tyre përgjatë zhvillimit të lëndës.</p>

<p>rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit ka të përcaktuar objektivat bazë dhe ato specifike, të cilat lidhen me qëllimin e ofrimit të njohurive në fushën e të drejtës së brendshme dhe atë ndërkombëtare (neni 3).</p> <p><i>Evidenca nr.4;</i> <i>Evidencat 5.1 & 5.2;</i> <i>Evidenca nr.13; Evidenca nr.93;</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p> <p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi” është i strukturuar në 10 (dhjetë) semestra akademik, 5 (pesë) vite akademike, 300 ECTS, 60 ECTS në cdo vit akademik.</p> <p>Ky program studimi ofron njohuri bazike dhe të thelluara në fushën e të drejtës. Lëndët janë të grupuara sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Lëndët që ofrojnë njohuri të thelluara akademike janë kryesisht në vitin e tretë, të katërt dhe të pestë të studimeve. Kjo shpërndarje ofron për studentët konsolidim të dijeve teorike të përfuara kryesisht në dy vitet e para akademike të studimeve. Raporti i lëndëve teorike me ato praktike është i përshtatshëm për këtë program studimi dhe në përputhje me objektivat e tij.</p> <p>Struktura e këtij programi studimi mundëson mobilitetin e studentëve brenda dhe jashtë vendit. Ky mobilitet brenda vendit mund të realizohet lehtësisht nga studentët për shkak të afërsisë dhe përshtatshmërisë së këtij programi me atë që ofrojnë universitetet e tjera në vend. Programi është i strukturuar mirë dhe për të mundësuar mobilitetin e studentëve jashtë vendit, kryesisht në vendet që kanë sistemin tonë të së drejtës (civil law system). Kjo për faktin se disa nga lëndët e formimit të përgjithshëm teorik dhe praktik ofrohen në gjuhën angleze si p.sh: Kërkimi dhe Shkrimi Ligjor, Të drejtat e Njeriut, E Drejta Tregtare etj.</p> <p><i>Evidenca nr.4;</i> <i>Evidencat 5.1 & 5.2;</i> <i>Evidenca nr.13;</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut</p>	<p>Stafi akademik që angazhohet në këtë program studimi përditëson dhe përmirëson programet e lëndëve, në raportin e duhur me qëllimin e lëndëve dhe zhvillimeve bashkohore në fushën e së drejtës (sipas minutave të takimit në institucion).</p>

të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<p>Në aktet e brendshme të institucionit është përcaktuar dhe përmirësimi i vazhdueshëm i programeve të studimit dhe përfshirja e stafit akademik në këtë proces.</p> <p><i>Evidenca nr.27 "Për përmirësimin vazhdueshëm të programeve të studimit;</i></p> <p><i>Evidenca nr.5.1 & 5.2;</i></p>		
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>Ky program studimi mundëson për studentët njohuri të thelluara në fushën e së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi bën pjesë në nivelin 7 të KSHK.</p> <p>Stafi akademik që është i angazhuar në këtë program studimi aplikon metodologjinë e përshtatshme akademike, e cila mundëson për studentët përfitim të njohurive akademike dhe shkencore.</p> <p><i>Evidenca nr.29 "Performanca akademike";</i></p>		
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në "Drejtësi" mundëson për të diplomuarit vijimësinë e studimeve në ciklin e tretë të studimeve si dhe daljen e tyre në tregun e punës për udhtrimin e profesionit të juristit. Ky program i jep mundësi studentëve për vijimin e studimeve në fushën e noterisë, avokatisë dhe magistratures. Ko për faktin se lëndët që përbejnë kurrikulën e këtij programi ofrojnë njohuri të thelluara në të drejtën publike, penale dhe civile.</p> <p><i>Evidenca nr.4;</i></p> <p><i>Evidenca nr.13</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në "Drejtësi" është i strukturuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi (në 10 (dhjetë) semestra akademik, 5 (pesë) vite akademike, 300 ECTS, 60 ECTS në cdo vit akademik).</i></p> <p><i>Ky program studimi ofron njohuri të thelluara në fushën e të drejtës, duke mundësuar për studentët konsolidim të dijeve teorike të përftuara me ato praktike, në përputhje me objektivat përkatëse.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” akreditohet për herë të parë dhe studentët që kanë ndjekur studimin në këtë program diplomohen këtë vit akademik. Pas diplomimit zyra përkatëse në institucion “Zyra e Karrierës dhe Alumni” si për cdo program tjetër në këtë institucion do të realizojnë sondazhet e duhura në lidhje me mundësinë e punësimit të tyre dhe aplikimit të njohurive të përfuara gjatë studimeve në tregun e punës.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni, organizon sondazhe me të diplomuarit dhe me kompanitë ku të diplomuarit janë të punësuar.</p> <p><i>Evidenca nr.95 “Pyetsor i sondazhit të Alumni”;</i> <i>Evidenca nr.96 “Sondazhi i kënaqsisë së kompanive;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Pëfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse të institucionit realizohet përmes procesit të zgjedhjes së tyre. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në këto organe.</p> <p>Mendimet dhe opinionet e studentëve janë pjesë e pyetsorëve dhe sondazheve, që realizohen nga zyrat përkatëse të institucionit. Aktet e brendshme të institucionit kanë të përcaktuara të drejtat e studentëve.</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i> <i>Evidenca nr.2; Evidenca nr.7;</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë, si njësia bazë në të cilën ofrohet ky program studimi, përditëson përmbajtjen e programit dhe në bazë të aktet të brendshme të institucionit, duke marrë në konsideratë dhe vlerësimet e studentëve.</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i> <i>Evidenca nr.2;</i> <i>Evidenca nr.95;</i></p>




e mjekësisë) dhe institucione publike e private.									
Konkluzione	<i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i> <i>Institucioni përmes zyrave përkatëse Zyra e Karrierës dhe Alumni) si për cdo program studimi organizon dhe realizon sondazhet e duhura në lidhje me mundësinë e punësimit të studentëve dhe aplikimit të njohurive të përftuara gjatë studimeve në tregun e punës. “Zyra e Karrierës dhe Alumni” organizon sondazhe me të diplomuarit dhe me kompanitë ku të diplomuarit janë të punësuar.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Rregullorja e programit të studimit të Integruar i Ciklit të Dytë në “Drejtësi” ka të përcaktuar si fushë prioritare të drejtën e brendshme dhe atë ndërkombëtare. Kurrikula e këtij programi studimi është përshtatur me objektivat bazë strategjike të institucionit, të cilat lidhen dhe me ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor. <i>Evidenca nr.1;</i> <i>Evidenca nr.21 “Plani Strategjik i Ndërkombëtarizimit;</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë akademike i këtij programi studimi, mundëson për stafin akademik dhe administrativ që angazhohet vënë këtë program, bashkëpunim në funksion të procesit akademik-shkencor. Institucioi mbështet financiarisht arritjet akademike dhe kërkimore shkencore të stafit akademik. <i>Evidenca nr.14 “Autonomia akademike dhe liria financiare”;</i>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” mundëson për stafin akademik dhe studentët pjesëmarrjen në aktivitetet kërkimore. Kjo pjesëmarrje lidhet me aktivitetet e organizuara nga strukturat akademike të institucionit dhe Departamentit të Drejtësisë (si njësi bazë për këtë program studimi).</p> <p><i>Evidenca nr.67 “Lista mbështetjes në aktivitete kërkimore-shkencore;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 68 “Lista e aktiviteteve shkencore të organizuara nga departamentit”;</i></p>			
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Institucioni mbështet financiarisht aktivitetin kërkimor të stafit akademik, përmes njësisë bazë.</p> <p>Stafi akademik që angazhohet pranë këtij programi studimi është i përfshirë në aktivitetet dhe publikime shkencore, të mbështetura dhe nga institucioni.</p> <p><i>Evidenca nr.67;</i></p> <p><i>E videnca nr.68;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Programi i studimit të Integruar i Ciklit të Dytë në “Drejtësi” ka të mirëpërcaktuar fushë e përgjithshme të studimit dhe ato prioritare, të cilat lidhen me të drejtën e brendshme dhe atë ndërkombëtare.</i></p> <p><i>Programi i studimit është përshtatur dhe me objektivat bazë strategjike të institucionit, të cilat lidhen me ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi II.7</p>	
<p>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p> <p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë (si njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi) bashkëpunon me zyrat përkatëse për projektet kërkimore-shkencore. Një ndër këto zyra është dhe Zyra e Kërkimeve dhe Projekteve, e cila realizon në bashkëpunim me stafin akademik aplikimin dhe ndjekjen e projekteve kërkimore-shkencore.</p> <p>Institucioni ka realizuar pjesëmarrjen në anëtarësim në projekte kërkimore ndërkombëtare dhe stafi akademik përmes këtij anëtarësimit institucional ka mundësi të bëhet pjesë rrejtizimi universitar në fushën e kërkimeve shkencore. Publikimet e stafit akademik që është i angazhuar në këtë program studimi tregojnë për pjesëmarrjen e aktive të këtij stafi në publikimet shkencore.</p> <p><i>Evidenca nr.61;</i> <i>Evidenca nr.93;</i> <i>Evidenca nr.64 "Lista e publikimeve";</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë (si njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi) mbështet stafin akademik dhe studentët në pjesëmarrjen e në veprimtari kërkimore, duke organizuar konferenca dhe aktivitetet të tjera në formën e forumeve të hapura.</p> <p><i>Evidenca nr.68 "Pjesëmarrja në aktivitete shkencore të stafit akademik";</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Institucioni ka në planin e tij strategjik ndërkombëtarizimin e të gjitha programeve të studimit, duke përfshirë dhe Programin e Integruar të Ciklit të Dytë të studimeve në "Drejtësi".</p> <p>Kurrikula e tëij programi studimi mundëson për studentët përfitim të dijeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke mundësuar për ata një punësim në një trek global. <i>Evidenca nr.4;</i></p>



<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p> <p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë, i cili është njësia bazë përgjegjëse për Programin e Integruar të Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet publike dhe private, është në kontakt me zhvillimet në fushën e drejtësisë dhe me kërkesat që tregu i punës ka në vijimësi.</p> <p>Ky program studimi (me 300 ECTS) mundëson për të diplomuarit vijimin e studimeve të tyre për profesionet e lira si avokat, përmbuarues noterë, magjistrat. Njëkohësisht të diplomuarit marrin titullin jurist në përfundim të studimeve dhe janë të gatshëm për të punuar në tregun e punës si specialist apo konsulent ligjor si dhe jruist në institucionet publike dhe private.</p> <p><i>Evidenca nr.4;</i> <i>Evidenca n r.13;</i> <i>Evidenca nr. 38 “Formati i diplomës;</i> <i>Evidenca nr.39 “Suplemanti i diplomës;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Departamenti i Drejtësisë mbështet dhe mundëson për stafin akademik dhe studentët pjesëmarrjen në veprimtari kërkimore, duke organizuar konferenca dhe aktivitetet të tjera në formën e forumeve të hapura, duke ftuar partnerë bashkëpunues të institucionit dhe të këtij programi studimi..</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	--	------------------------------	-----------------------------	--

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT



Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Rregullorja e Programit të Integruar të Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi ka të përcaktuar format e mësimdhënies dhe objektivat përkatëse të procesit akademik. Format më kryesore të mësimdhënies janë leksionet dhe seminarët.</p> <p>Format e mësimdhënies janë të koordinuara me procesin e mësimnxënies, duke mundësuar për studentët shprehitë e dijeve në formën e detyrave të kursit, projekteve, provimeve dhe debateve akademike në auditor.</p> <p><i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.5.1 & 5.2;</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, mundëson përmes metodave interaktive përfshirjen e studentëve gjatë procesit mësimor (sipas minutave të takimit të GVJ në institucion).</p> <p>Në varësi të natyrës së lëndëve akademik, stafi organizon dhe procesin në auditor të dhënies së informacionit dhe dijeve përkatëse. <i>Evidenca nr.5.1 & 5.2;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni ofron për stafin akademik trajnime të vazhdueshme në lidhje me përdorimin dhe aplikimin metodave interaktive dhe të dixhitalizuara të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca nr.18 “Lista e aktiviteteve trajnuese”;</i> <i>Evidenca nr.19 “Lista e pjesëmarrjes në aktivitetet akademike të departamentit”;</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si</p>	<p>Institucioni e ka prioritet angazhimin e stafit akademik, i cili zotëron njohuritë e duhura metodike në fushën përkatëse. Ky prioritet aplikohet që në fazën e parë të rekrutimit të personelit akademik. Në këtë fazë të rekrutimit aplikantët duhet të zhvillojnë një leksion të hapur për të demonstruar aftësitë e tyre pedagogjike në fushën përkatëse.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi bashkëpunon me strukturat drejtuese dhe ndërmjet tyre për</p>

<p>dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>ndarjen e eksperiencave akademike. Pjesë e mbështetjes së studentëve është dhe konsulenti akademik, i cili, mundëson dhe një lidhje ndërmjet studentëve, stafit akademik dhe drejtuesve të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca nr.99 "Formulari vlerësues për leksionin e hapur"; Evidenca nr.93/tabela 12;</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni ka krijuar mekanizmat/instrumentet e duhur për vlerësimin dhe përmirësimin në vijimësi të programeve të lëndëve dhe programit të studimit në tërësi, përmes sondazheve përkatëse.</p> <p><i>Evidenca nr.13;</i></p> <p><i>Evidenca nr.27 "Politika për përmirësimin në vijimësi të programeve të studimit";</i></p> <p><i>Evidenca nr.31 "Sondazh vlerësues për titullarët e lëndëve";</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni e ka pjesë të strategjisë së tij përmirësimin në vijimësi të procesit akademik, përmes përfshirjes së të gjitha strukturave akademike, ndihmës-akademike dhe administrative.</p> <p>Shtyllat bazë të strategjisë së institucionit lidhen me procesin akademik në tërësi dhe kërkimor-shkëncor. Stafit akademik trajnohet në vijimësi për të përmirësuar metodat e mësimdhënies dhe për të përdorur metodat më inovative, në varësi të cdo programi studimi.</p> <p>Bashkëpunimi ndërmjet njësive është i përcaktuar në aktet bazë të institucionit. Zyra që mbështet në mënyrë të vazhdueshme dhe specifike përdorimin dhe aplikimin efektiv të metodologjisë së duhur në procesin akademik është zyra e koordinuese e teknologjisë së inovacionit dhe komunikimit.</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i></p> <p><i>Evidenca nr.2;</i></p> <p><i>Evidence Nr.12;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Institucioni përmes njësive dhe zyrave përkatëse ofron për stafin akademik trajnime të vazhdueshme në lidhje me përdorimin dhe aplikimin e metodave interaktive dhe të</i></p>



	<i>dixhitalizuara të mësimdhënies, duke mundësuar për studentët një përfitim sa më të mirë të njohurive në auditor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e Programit të Integruar të Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” si dhe rregullorja specifike e institucionit “Për Ciklin e Dytë të Studimeve”, kanë të përcaktuara format e vlerësimit të njohurive të studentëve, sipas komponentëve të përcaktuara në syllabus-et e lëndëve. Këto komponentë të vlerësimit bëhen të njohura për studentët në cdo fillim semestri, nga stafi akademik përgjegjës për cdo lëndë. Syllabus-et e lëndëve publikohen online përpara fillimit të semestrit dhe studentët kanë mundësi të njihen me të gjithë komponentët e lëndës, duke përfshirë dhe format e kontrollit të njohurive dhe dijeve që do të përftoheshin përgjatë lëndës. Në platformën përkatëse të krijuar nga institucioni studentët kanë mundësi të aksesojnë informacionin e nevojshëm mbi përmbajtjen e lëndëve që do të ndjekin, dipas semestrit dhe vitit akademik që janë duke zhvilluar.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Zyrat përkatëse (zyra e regjistrimit të studentëve) informojnë studentët mbi format dhe mënyrat e testimit dhe për këtë institucioni ka të miratuar dhe një udhëzues të posaçëm për studentët. <i>Evidenca nr.2 “Rregullore për ciklin e dytë të studimeve”;</i> <i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.5.1 & 5.2;</i> <i>Evidenca nr.78 “Udhëzues smart për studentët”;</i> <i>Evidenca nr.89 “Udhëzues për sistemin interaktiv për studentët”;</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	

Konkluzione	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Institucioni përmes rregulloreve përkatëse (rregullorja e Programit të Integruar të Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” si dhe rregullorja specifike e institucionit “Për Ciklin e Dytë të Studimeve”), ka përcaktuar format e vlerësimit të njohurive të studentëve, sipas komponentëve të përcaktuara dhe në syllabus-et e lëndëve, të cilat bëhen të njohura për studentët në cdo fillim të semestrit akademik.</i></p> <p><i>Ato publikohen online përpara fillimit të semestrit dhe studentët kanë mundësi të njihen dhe përmes platformës përkatëse të krijuar nga institucioni.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Institucioni përmes rregulloreve të programit të studimit dhe vendimeve dhe udhëzimeve përkatëse (udhëzuesin për provimet) ka të përcaktuara procedurat dhe kalendarin e provimeve/vlerësimit të dijeve të studentëve. Këto akte të brendshme janë në nivel institucional dhe janë të njohura për stafin akademik dhe studentët. Njësitë përkatëse kanë përgjegjësinë e monitorimit dhe zbatimit të procedurave të vlerësimit të dijeve të studentëve, duke krijuar dhe grupet përkatëse të monitorimit të procesit.</p> <p><i>Evidenca nr.. 13- Regulation of PICD Law program;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Procesi i kontrollit të dijeve dhe vlerësimi i tyre është një proces që siguron anonimin dhe transparencën. Zyra përkatëse (IT-së) mundëson realizimin e këtij procesi në aspektin e vënies në infrastrukturës së nevojshme për stafin akademik. Institucioni ka një sistem të posaçëm për procesin e rezultateve të vlerësimeve (SIE).</p>

<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar për këtë program studimi është përgjegjës për vlerësimin e studentëve sipas komponentëve të miratuara në programet e lëndëve përkatëse. Mënyrat e vlerërimit apo të kontrollit të dijeve janë të njohura për studentët në fillim të cdo semestri akademik, përmes syllabus-ëve të lëndëve dhe informacionit që i mundësohet nga pedagogët e lëndëve dhe stafi administrativ.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Stafi akademik informon studentët për vlerësimet përkatëse. Pedagogët e realizojnë procesin e kontrollit të dijeve përmes komentet përkatëse në fletët e testimeve/provimeve dhe studentët kanë të drejtë të njihen me ato.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Njësia bazë për këtë program studimi (Departamenti i Drejtësisë), miraton caktimin e ekspertëve për cilësinë mbi vlerësimin e provimeve (<i>sipas RVB-së fq.45</i>). Kjo mënyrë siguron cilësinë dhe transparencë në lidhje me rezultatet e provimeve.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Institucioni ka të miratuar aktin përkatës në lidhje me plagjarizmin (udhëzues për studentët). Rregullorja e institucionit ka të përcaktuara dhe masat disiplinore në rastet e konstatimit kopjimit apo plagjarizmit nga ana e studentëve.</p> <p><i>Evidenca nr.2;</i> <i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.35 "Procesi i anonimatit të provimeve";</i> <i>Evidenca nr.32 "Udhëzues për provimet";</i> <i>Evidenca nr. 36 "për bordin e bordin e provimeve";</i> <i>Evidenca nr.33 "Rregullorja për disiplinimin e studentëve";</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në rregulloret përkatëse të institucionit dhe të këtij programi studimi janë të përcaktuara të drejtat e studentëve në lidhje me vlerësimin e dijeve të tyre dhe procesin e ankimit apo reklamimit të notës.</p> <p>Zyra e regjistrimit merr ankesat përkatëse të studentëve për provimet dhe informon pedagogët e lëndëve, të cilët verifikon nëse në vlerësimin e studentit ka ndonjë gabim që mund të reflektohet nga ana e tij, duke hartuar dhe raportin përkatës dhe</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga</p>	

<p>komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>mbi bazën e formularit të aplikimit të ankesës. Këto i dërgohen Dekanit dhe më pas merret vendimi përkatës. Vendimi i bëhet i njohur studentit brenda afatit të përcaktuar në rregullore.</p> <p>Institucioni ka ngritur dhe bordin e provimeve, i cili në mënyrë të pavarur bën kontrollin mbi cilësinë e provimeve dhe harton një raport mbi të gjitha lëndët e programeve të sutudimeve.</p> <p><i>Evidenca nr. 2;</i> <i>Evidenca nr.7;</i> <i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidsenca nr.36;</i> <i>Evidenca nr.72 "Mbi raportin e bordit të provimeve";</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Institucioni përmes akteve të brendshme (regullore të programit të studimit, vendimeve dhe udhëzimeve përkatëse për provimet) ka të përcaktuara procedurat e zhvillimit të provimeve.</i></p> <p><i>Njesitë përkatëse kanë përgjegjësinë e monitorimit dhe zbatimit të procedurave të vlerësimit të dijeve të studentëve, duke garantuar anonimatën dhe transparencën e procesit. Zyra përkatëse (zyra e IT-së) mundësojnë realizimin e këtij procesi në aspektin, duke mundësuar dhe funksionimin e sistemit të posaçëm për procesin e rezultateve të vlerësimeve (SIE).</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4</p>	
<p>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p> <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Kurrikula ë këtij programi studim ofron lëndë bazë teorike (kryesisht në vitin e parë dhe të dytë akademik) si dhe lëndë të disiplinave të ngjashme si p.sh., “Hyrje në Ekonomi”, “Hyrje në Shkencat Politike”, “Sociologjia e Ligjit” të cilat ofrohen në anglisht. Në këtë program studimi ofrohen dhe lëndë, të cilat mundësojnë për studentët aftësim të njohurive akademike dhe shkencore në fushën e të drejtës si psh: “Bazat dhe metodat e arsytimit e shkrimit ligjor”, “Kërkim dhe shkrim shkencor” (në anglisht).</p> <p>Në këtë program studimi, disa nga lëndët bazë, etike dhe të lidhura më garancitë dhe të drejtat e njeriut, ofrohen edhe në anglisht si p.sh. “E Drejta Kushtetuese”, “Etika Ligjore”, “Të Drejtat e Njeriut”. Nësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, organizon dhe trajnime për studentët dhe stafin akademik në fushën e teknologjisë së informacionit, duke mundësuar përdorimin efektiv të programeve dhe platformave dixhitale.</p> <p><i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.5.1&5.2;</i> <i>Evidenca nr.4;</i> <i>Evidenca nr.68 “Përfshirja e studentëve nëaktivitetet e njësisë”;</i> <i>Evidenca nr. 88 “Udhëzim për përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit”;</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.</p>	<p>Kurrikula e këtij programi studimi përmban lëndë të lidhura me disiplinat bazë në fushën e drejtësisë dhe më disiplinat e tjera të ngjashme, duke mundësuar për studentët zhvillimin e aftësive analitike. Kjo realizohet përmes metodave të mësimdhënies të përshkruara në syllabus-et e lëndëve.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përshtat metodat e mësimdhënies me përmbajtjen dhe qëllimin e lëndëve, duke i përditësuar ato me zhvillimet aktuale në fushën përkatëse.</p> <p>Komponentët e programeve të lëndëve përmirësohen në lidhje me literaturën dhe temat e lidhura me atë. Për vlerësimin e syllabuse-eve të lëndëve caktohen ekspertë të jashtëm, të cilat në bazë të formularit përkatës bëjnë vlerësimet përkatëse.</p> <p><i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.37;</i></p>




	<i>Evidenca nr.5.1 & 5.2;</i>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program nxit pjesëmarrjen aktive të studentëve në auditor, duke realizuar objektivat e lëndëve përkatëse dhe duke përshtatur metodat e mësimdhënies me aplikimin në praktikë të njohurive dhe dijeve të përftuara nga studentët (<i>sipas minutave të takimit të GVJ në institucion</i>).</p> <p>Kurrikula e këtij programi studimi është e përshtatur me përmbajtjen e programeve të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, duke mundësuar mobilitetin e studentëve. Institucioni ka dhe marrëveshje partneriteti me institucionet homologe, të cilat shërbejnë dhe për shkëmbime akademike.</p> <p><i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.5.1 & 5.2;</i> <i>Evidenca nr.27;</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë, si një sia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, mundëson për stafin akademik të përfshirë në procesin mësimor trajnime që lidhen me kërkimin shkencor dhe aftësimin në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Studentëve ju mundësohet gjithashtu pjesëmarrje në aktivitet akademike të organizuara nga institucioni dhe njësia bazë.</p> <p><i>Evidenca nr.67;</i> <i>Evidenca nr.93/tabela 22;</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuarra kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Institucioni ka një strukturë ndihmës-akademik në mbështetje të studentit, sic është dekanati i studnetëve, i cili mundëson përfshirjen e studentëve në aktivitetet e organizuara nga njësitë përbërëse të institucionit.</p> <p><i>Evidenca nr.59 "Raport vjetor i veprimtarive të dekanatit të studentëve;</i></p>

Konkluzione	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Programi i Studimit të Ciklit të Dyrë në “Drejtësi” ofron lëndë bazë teoriko-praktike si dhe lëndë të disiplinave të ngajshme (si p.sh., “Hyrje në Ekonomi”, “Hyrje në Shkencat Politike”, “Sociologjia e Ligjit”), të cilat ofrohen në anglisht. Gjithashtu ofrohen dhe lëndë, të cilat mundësojnë për studentët aftësim të njohurive akademike dhe shkencore në fushën e të drejtës (si psh. “Bazat dhe metodat e arsytimit e shkrimit ligjor”, “Kërkim dhe shkrim shkencor” si dhe lëndë që lidhen me etikën profesionale në fushë e të drejtës (si p.sh. “Etika Ligjore”).</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p> <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Institucioni, përmes akteve të brendshme të mratuara, ka të përcaktuara procedurat në lidhje me detyrimet përmbyllëse të studentëve.</p> <p>Stafi akademik mbështet studentët për realizimin e detyrimeve përmbyllëse të këtij programi studimi. Njësia përkatëse përcakton dhe udhëheqësit për cdo temë diplome që do të realizohet nga studentët. Teza e diplomimit është pjesë kurrikulës së këtij programi studimi me 12 ECTS. Miratimi i udhëheqësve bëhet me vendim të dekanatit, në bazë të propozimeve nga njësia bazë.</p> <p>Studentët informohen në lidhje me procedurat dhe realizimin e detyrimeve përmbyllëse, pasi institucioi ka të miratuar dhe një udhëzues të posaçëm për skrimin e tezës së diplomës, e cila është online.</p> <p><i>Evidenca nr. 2;</i></p> <p><i>Evidenca nr.13;</i></p>



	<i>Evidenca nr. 105 "Raportii provimeve të tezës për studentët e masterit";</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<p>Në këtë program studimi, detyrimi përmbyllës realizon në bazë të tezës së diplomimit, e cila realizohet në bazë të rregullores së institucionit për ciklin e dytë të studimeve dhe rregullores së posacme të këtij programi.</p> <p>Meqensë ky është një program studimi që në fund të studimeve diploma është e klasifikuar si diplomë e ciklit të dytë studimeve, në këtë program teza e diplomimit është një lëndë me 12 ECTS. Kjo temë/tezë realizohet në bazë të rregullares që lidhet me shkrimin akademik dhe kontrolllet mbi plazhrizmin.</p> <p><i>Evidenca nr.2;</i></p>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	<p>Stafi akademik i angazhuar në procesin e detyrimeve përmblydhëse të studentëve, mbështet ata deri në realizimin përfundimtar. Miratimi i temave të diplomave të ciklit të dytë të studimeve bëhet nga dekanati me propozimin e njësisë bazë, e cila angazhon stafin akademik në rolin e udhëheqësve dhe realizuaesve të procesit në aspektin akademik dhe procedural.</p> <p>Komisioni i mbrojtjes së tezës së diplomimit krijohet me vendim të dekanatit dhe përbëhet nga tre anëtare, të cilat në fund të procesit hartojnë dhe procesverbalin/vendimin përkatës të vlerësimit.</p> <p><i>Evidenca nr.2;</i></p> <p><i>Evidenca nr.13;</i></p> <p><i>Evidenca nr.105;</i></p>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Njesitë përgjegjëse të institucionit mundësojnë mbështetjen akademike dhe infrastrukurore/teknologjike në stafit akademik dhe studentët për realizimin e kërkimit shkencor në funksion të detyrimeve përmbylluse apo që zhvillohen përgjatë viteve akademik.

<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i krijuar në bazë të aktit përkatës vlerëson në fund të mbrojtjes së diplomës studentin. Ky proces realizohet në bazë të akteve të brendshme të miratuara nga institucioni.</p>		
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Institucioni e pajis në fund të procesit të diplomimit studentin me diplomën dhe suplementin përkatës, të cilat janë të miratuara dhe për këtë program studimi.</p> <p>Në këtë program studimi studentët janë në fazën e përmbushjes së detyimeve përmbyllëse, atëherë mbrojtjes së temës/tezës së diplomit.</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i> <i>Evidenca nr.2;</i> <i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.38 "Formati i diplomës për programin e integruar në "Drejtësi";</i> <i>Evidenca nr.39 "Suplementi i Diplomës për Programin e Integruar në "Drejtësi";</i></p>		
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Institucion arkivon në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe akteve të brendshme, dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor dhe të gjitha fazat përmes të cilave kalon ky proces deri në diplomimin e studentit.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Institucioni ndjek në vijimësi, përmes akteve të brendshme të miratuara, procedurat në lidhje me detyrimet përmbyllëse të studentëve, duke i mbështetur ata deri në fund të këtij procesi.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	NA			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	NA			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	NA			
Konkluzione	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Kriteret e lidhura me këtë standard janë të pa aplikueshme për këtë program studimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, kërkuar gjatë vizitës në institucion (<i>Annex Nr. 93-Tabela Permbledhese, tab 6.1-6.5</i>).për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit Msc në Drejtësi janë angazhuar staf akademik për pesë vite akademike si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2018- 2019 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 11 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 4 PAK (63 % /37 %); 2. Për vitin akademik 2019- 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 17 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 7 PAK (60% /40 %); 3. Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 19 pedagogë nga të cilët 12 PAE dhe 7 PAK (63% / 37%); 4. Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 24 pedagogë nga të cilët 13 PAE dhe 11 PAK (55 % / 45 %); 5. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 22 pedagogë nga të cilët 13 PAE dhe 9 PAK (60 % / 40 %):

Tituj/ grada	2018-2019		2019-2020		2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	2	-	2	-	2	2	1
Prof. Asoc.	1	-	1	-	1	-	1	1	1	-
Dr./PhD	4	2	7	2	7	1	8	4	8	8
Msc.	2	2	2	3	4	4	4	4	2	-
Totali	7	4	10	7	12	7	13	11	13	9

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të ciklit të dytë Msc në Drejtësi, janë angazhuar edhe staf akademik me Msc, në ndryshim nga parashikim i nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet: “Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”.

Kualifikimi i personelit është një nga prioritetet strategjike të institucionit, arsye për të cilën janë parashikuar një sërë lehtësish, stimuljsh edhe mbështetje financiare për nxitjen e përparimit akademik.

GVJ rekomandon të meren masat e nevojshme për të mundësuar që personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në realizimin e programit të studimit të ketë të paktën gradën shkencore Dr., në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.

Evidenca nr. 1;

Evidenca nr. 6;

Evidenca nr. 12;

Evidenca nr. 19;

Evidenca nr. 24;

Evidenca nr. 61;

Evidenca nr. 64;

Evidenca nr. 67-69;

	<i>Evidenca nr. 93 (tabela 1.1-1.5 dhe 6.1, 6.5)</i>																														
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik në kuadrin e përgjegjësive institucionale, përveç veprimtarive të mësimdhënies, kryen edhe kërkim shkencor, shërbime për zhvillimin e institucionit, konsultim dhe këshillim për studentët si dhe shërbime administrative. Shpërndarja e ngarkesës mësimore merr në konsideratë edhe përgjegjësitë administrative të stafit akademik në funksion të menaxhimit të programit të studimit.</p> <p>Nga verifikimi i të dhënave statistikore (<i>ref. Tabelave 12.1, 12.2, 12.3, 12.4 dhe 12.5</i>), u konstatua se për pesë vitet akademike mbulimi i ngarkesës mësimore sipas viteve akademike është si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="549 734 1374 1182"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>704</td> <td>512</td> <td>192</td> <td>73% / 27%</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>1392</td> <td>928</td> <td>464</td> <td>67% / 33%</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>2080</td> <td>1568</td> <td>512</td> <td>75% / 25%</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>2736</td> <td>1552</td> <td>1184</td> <td>56.7% / 43.3%</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>3120</td> <td>1936</td> <td>1184</td> <td>63% / 37%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga sa më sipër rezulton se për 3 vite akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, <i>nuk</i> është përballuar me <u>mbi</u> 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “<i>Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi</i>”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë përgjegjëse të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis PAE dhe PAK në këtë program studimi në mënyrë që mbulimi i ngarkesës nga PAE i angazhuar në procesin e mësimdhënies të përputhet tërësisht me standartet e kërkuara që i referohen mbulimit të ngarkesës mësimore (70%).</i></p> <p><i>Evidenca 1;</i> <i>Evidenca nr. 71;</i></p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2018-2019	704	512	192	73% / 27%	2019-2020	1392	928	464	67% / 33%	2020-2021	2080	1568	512	75% / 25%	2021-2022	2736	1552	1184	56.7% / 43.3%	2022-2023	3120	1936	1184	63% / 37%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																											
2018-2019	704	512	192	73% / 27%																											
2019-2020	1392	928	464	67% / 33%																											
2020-2021	2080	1568	512	75% / 25%																											
2021-2022	2736	1552	1184	56.7% / 43.3%																											
2022-2023	3120	1936	1184	63% / 37%																											

	<p><i>Evidenca 93 (Tabela 1, 4, 6, 12);</i></p> <p><i>Evidenca 7 (dokumentacioni vizita në institucion);</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Aktet normative të institucionit parashikojnë rregullime të detajuara në lidhje me procedurat e përzgjedhjes dhe rekrutimit të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Procedurat e punësimit finalizohen me lidhjen e kontratës së punës për të gjitha kategoritë e personelit akademik.</p> <p>Rregullimet në lidhje me kontratën e punës, kushtet dhe kohëzgjatjen, të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik janë të detajuara në Statutin e Universitetit si dhe referojnë në Kodin e Punës, Ligjin për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Statuti i Universitetit përcakton në detaje kushtet mbi kohëzgjatjen e kontratës së punës në varësi të kategorisë së personelit akademik, atij me kontratë dhe atij efektiv. Rregullime parashikohen edhe për rinovimin e kontratave të personelit të kategorisë “Profesor”, i cili ka mbushur moshën për pension.</p> <p>Parashikime të detajuara mbi kontratat e punës, kriteret dhe procedurat e punësimit gjenden edhe në akte rregullore të posaçme që i referohen marrëdhënieve të punës.</p> <p><i>Evidenca nr. 1, Evidenca nr. 15, Evidenca nr. 92 “Shembull kontrate punësimi”;</i></p> <p><i>Evidenca nr.7 (dokumentacioni vizita në institucion), Evidenca nr. 8 “Shënime Epoka”;</i></p> <p><i>dokumentacioni vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti “Epoka” gëzon autonomi organizative si dhe të përzgjedhjes së personelit. Iniciativa për punësimin e stafit akademik me kohë të plotë ose më kohë të pjesshme inicohet nga Departamenti si njësi bazë në përputhje me nevojat e procesit mësimor. Departamenti propozon gjithashtu edhe kriteret e punësimit të personelit akademik bazura në nevojat e tij, të cilat miratohen nga Rektorati.</p> <p>Në procesin e punësimit i kushtohet rëndësi kombinimit të nevojave të njësisë bazë për personel me kualifikimin shkencor dhe përvojën e kandidatëve. Aketet rregullore të brendshme kanë përcaktura rregulla dhe procedura të hollësishme për punësimin e personelit akademik si për atë efektiv, ashtu edhe për atë me kontratë. Rregullime të detajuara i referohen edhe procedurave të vlerësimit të punës, kriterëve të promovimit, nxitjes dhe</p>

	<p>mbështjes së kualifikimit akademik etj. Me qëllim rritjen e transparencës, rregullorja e posaçme mbi rekrutimin e stafit specifikon kritere të rekrutimit jo vetëm për stafin akademik, por edhe për atë ndihmës akademik dhe administrativ.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 15;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 16 “Guida për stafin”;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 98 “Formular aplikimi për stafin akademik”;</i></p> <p><i>Evidenca nr.7 (dokumentacioni vizita në institucion);</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin e këtij programi studimi institucioni ka anagazhuar personel ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm i cili ndihmon dhe mbështet realizimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimit shkencor. Aktet normative parashikojnë gjithashtu rregullime në lidhje me kriteret dhe procedurat e punësimit të kësaj kategorie me qëllim rekrutimin e personelit të kualifikuar dhe garantimin e qëndrueshmërisë në detyre. Statuti ka parshikime të detajuara në lidhje me kriteret dhe procedurat e punësimit si dhe elementët që lidhen me kontratën e punës. Punësimi i personelit ndihmës akademik gjithashtu realizohet nëprmet procedurave të konkurimit ku përfshihen një sërë strukturash, nga Departamenti deri tek Bordi i Administrimit.</p>
	<p><i>Evidenca nr. 1;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 15;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 7 (dokumentacioni vizita në institucion);</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni administron të dhënat që i referohen burimeve njerëzore të angazhuar në programin e studimit. Në të dhënat e administruara specifikohet mënyra e angazhimit të personave përgjegjës për çdo vit akademik apo semestër. Zyra e Burimeve Njerëzore si njësi përgjegjëse administrative, ruan dhe përditëson si të dhënat e stafit akademik, ashtu edhe atij administrativ të angazhuar në programin e studimit. Administrimi i të dhënave të personelit realizohet si në formatin fizik, nëprmet dosjeve të personelit, ashtu edhe në formatin elektronik. Për këtë qëllim janë hartuar formularë elektronikë dedikuar të dhënave të personelit. Njësitë e tjera përgjegjëse si Sekretaria Mësimore, Departamenti etj, bashkërendojnë punën ndërmjet tyre në mbledhjen dhe përditësimin e të dhënave.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i></p>

	<p><i>Evidenca nr. 20;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 91, "Direktiva për ngarkesën mësimore";</i></p> <p><i>Evidenca 93 (tabela 4);</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti ka burimet e nevojshme njerëzore për të mundësuar mbështetjen dhe asistencën ndaj studentëve në veprimtari të funksionit të programit të studimit. Zhvillimi i praktikës profesionale, është një ndër lëndët e detyrueshem në kurrikulën e këtij programi të studimit. Për të mundësuar realizimin e praktikave profesionale në këtë program studimi janë lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit me një sërë institucionet publike dhe private. Bazuar në këto marrëveshje, studentëve u mundësohet logjistika dhe mbështetja e nevojshme në zhvillimin e praktikave dhe ofrimi i eksperiencës në fusha të caktuara të ligjit. Praktikantët profesionale zhvillohen nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti, i cili në rolin e supervisorit, asiston studentët. Aktet e posaçme rregullatore kanë përcaktura në detaje kompetencat dhe rolin e Supervisorit të Departamentit si dhe aspektet e bashkëveprimit me studentët dhe përfaqësuesit e institucionit ku zhvillohet praktika. Personeli akademik i Departamentit të Drejtësië në kuadrin e veprimtarive në mbështetje të studentëve ushtron funksionet e konsulentit akademik duke mbështetur dhe orinetuar studentët edhe mbi procedurat dhe kriteret e diplomimit.</p> <p><i>Evidenca nr.11;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 53, Evidenca nr. 69;</i></p> <p><i>Evidenca nr. AN1411-1;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 105;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 7 (dokumntacioni shtesë);</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit</p>	<p>Aktet rregullatore të institucionit që i referohen zhvillimit të praktikave profesionale kanë parashikuar procedura të bashkëveprimit midis strukturave përgjegjëse për zhvillimin e praktikës pranë Departamentit të Drejtësiës si dhe përgjegjësive konkrete që u referohen institucioneve ku do të zhvillohet praktika profesionale. Në institucionet ku zhvillohet praktika caktohet një mentor i cili mbikëqyr studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së praktikës profesionale. Aktet që i referohen praktikës profesionale kanë detajuar kompetencat për këtë kategori, përfshirë edhe detyrimin për të firmosur Formularin përfundimtar të përmbushjes së praktikës profesionale.</p>

të tyre për praktikën profesionale.	Evidenca nr. 53; Evidenca nr.54;		
Konkluzione	<p>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</p> <p>Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë në të cilën ofrohet ky program studimi, përbëhet nga stafi akademik me kohë të plotë (PAE) dhe stafi akademik me kohë të pjesshme (PAK), të kualifikuar dhe me përvojë profesionale, sipas standarteve të përcaktuara ligjore.</p> <p>Institucioni ka hartuar dhe zbaton procedurat e nevojshme që i referohen rekrutimit, promovimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik, atij ndihëms akademik dhe administrativ.</p> <p>GVJ rekomandon që Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë përgjegjëse të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis PAE dhe PAK në këtë program studimi në mënyrë që mbulimi i ngarkesës nga PAE i angazhuar në procesin e mësimdhënies të përputhet tërësisht me standartet e kërkuara që i referohen mbulimit të ngarkesës mësimore (70%).</p> <p>Rekomandohet gjithashtu marja e masave të nevojshme për të mundësuar që personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në realizimin e programit të studimit të ketë të paktën gradën shkencore Dr. në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në	Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” realizohet në një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore për studentët dhe stafin akademik. Hapësirat që i referohen veprimtarisë mësimore në Universitetin “Epoka” shtrihen në një sipërfaqe prej 17.452 m ² . Në funksion

<p>përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>të procesit të mësimdhënies institucioni mundëson 10 salla leksionesh me një sipërfaqe prej 1153.96 m² dhe 24 salla seminaresh me sipërfaqe 1851.47 m². Për stafin akademik dhe atë administrativ është në dispozicion një sipërfaqe prej 2523.8 m². Në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale si njësi kryeore përgjegjëse për këtë program studimi janë në dispozicion: 5 klasa seminaresh me një sipërfaqe prej 284 m² dhe kapacitet 172 persona. 10 auditore me një sipërfaqe prej 1153.96 m² dhe kapacitet 881 persona, nga të cilat, 3 salla leksionesh në sipërfaqe prej 210m².</p> <p>Institucioni disponon gjithashtu një sërë mjedisesh mbështetëse si salla kompjuterash, laboratorë informatike, një sallë biblioteke, sallë konferencash si dhe një sërë mjedisesh për ushtrimin e aktiviteteve shplohëse e rikreative për studentët.</p> <p>Mjediset mësimore si mjedisi i bibliotekës, si dhe gjithë facilitetet e tjera në shërbim të studentëve janë object i sondazheve dhe pyetësorëve duke u mundësuar studentëve të shprehin vlerësimin e tyre në lidhje me infrastrukturën në funksion të procesit mësimor. Këto sondazhe i nështrohen analizave nga strukturat kompetente me qëllim marjen e masave dhe përmirësimin e mangësive.</p> <p><i>Evidenca nr. 76; Evidenca nr. 77 “Raport i verifikimit të kapaciteteve 2022-2023”;</i> <i>Evidenca nr. 93 (tabela 16);</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset e zhvillimit të procesit mësimor, që i dedikohen këtij program studimi, janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike dhe didaktike që mundësojnë përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale ku zhvillohet ky program studimi disponon salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorë, zyra, e mjedise të tjera në funksion të procesit të mësimdhënies. Të gjitha mjediset mbulohen me WI-FI që mundëson akses ndaj internetit në funksion të programit të studimit.</p> <p>Në funksion të një procesi bashkëkohor të mësimdhënies, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me mjetet e nevojshme elektronike dhe teknologjike si videoprojektorë Smart TV, whiteboard etj. Pajisja e mjedisëve me teknologjinë bashkëkohore mundëson zhvillimin e një procesi mësimor në</p>

	<p>kushte optimale dhe nëpëmjet përdorimit të teknologjive të reja të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca nr. 76;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 77;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 93 (tabela 17);</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Mjediset ku zhvillohet ky program studimi përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme teknologjike dhe didaktike në përshtatje me objektivat formues të programit të studimit. Pjesë e infrastrukturës së Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale është një sallë konferencash. Aksesin ndaj shërbimit të internetit mundëson forma të edukimit në distancë si dhe zhvillimit të veprimtarive shkencore on-line.</p> <p>Me qëllim aftësimin praktik të studentëve, në dispozicion të studentëve të këtij program është edhe një sallë gjyqi me kapacitet 25 persona, e pajisur me mjetet e përshtatshme për zhvillimin e gjyqeve stimuluese ose aktiviteteve të ngjashme të aftësimin praktik. Në mbështetje të programeve të studimit që ofrohen nga Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale janë edhe një sërë mjedisesh të tjera si dhomë interenti, laboratorë, dhomë fotokopje etj. Të gjitha janë të pajisura me mjetet e nevojshme infrastrukturore dhe teknologjike në funksion të nevojave në mbështetje të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca nr. 76;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 77;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 88;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Kurrikula e Programit të Integruar të Ciklit të Dytë të Studimeve në “Drejtësi” nuk parashikon orë laborator. Pjesë e infrastrukturës së Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale ku zhvillohet ky program janë edhe një dhomë interneti si dhe një laborator informatike që mund të aksesohen edhe nga studentët e këtij programi.</p> <p>Njesitë përgjegjëse të institucionit si dhe stafi akademik nxisin përdorimin nga studentët të të gjitha potencialeve infrastrukturore/teknologjike për realizimin e kërkimit shkencor ose detyrimeve që i referohen procesit akademik.</p> <p><i>Evidenca nr. 76;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 88;</i></p>

	<i>Evidenca 93 tabela 16;</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	<p>Zhvillimi i praktikës profesionale për këtë program studimi mundësohet si pasojë e marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura me një sërë institucionesh publike dhe private.</p> <p>Praktika zhvillohet në mjediset e institucioneve me të cilët janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Studentët mund të zhvillojnë praktikën profesionale në mjediset e institucioneve/kompanive për të cilat është marrë aprovimi i departamentit nëpërmjet një formulari të posaçëm. Studentët e zhvillojnë praktikën profesionale pasi janë konsultuar me supervizorin e caktuar nga Departamenti për mbikqyrjen e studentit në praktikën profesionale.</p> <p><i>Evidenca nr. 53 “Udhëzues mbi zhvillimin e praktikës profesionale për studentët e ciklit të parë dhe programit të integruara të ciklit të dytë të studimeve”;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 8 “Shënime në institucion” (dokumentacioni vizita në institucion);</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet s më poshtë:</i></p> <p><i>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” zhvillohet në një infrastrukturë dhe mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore për studentët dhe stafi akademik.</i></p> <p><i>Mjediset e zhvillimit të procesit mësimor që i dedikohen këtij program studimi, janë të paisura me mjetet e nevojshme teknologjike dhe didaktike që mundësojnë përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Studentët dhe stafi akademik i këtij programi kanë qasje në të gjitha mjediset dhe mjetet e teknologjike e didaktike që i shërbejnë objektivave formues të programit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X


Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Pjesë e syllabuseve të lëndëve të këtij program studimi është edhe literatura e detyrueshme dhe e këshillueshme. Studentët njihen më literaturën nëpërmjet programit mësimor në fillim të procesit akademik, si dhe gjatë vijëmsi të procesit të mësimdhënies nëpërmjet komunikimit me pedagogun përgjegjës. Studentët njihen me literaturën e syllabuseve si në formë elektronike, ashtu edhe në hard copy. Nga shqyrtimi i programeve mësimore të lëndëve/moduleve, konkludohet se elementi i literaturës që i referohet syllabuseve të ndryshme është literaturë bashkëkohore. Burimet e literaturës janë në përshtatje me dijet që synohet ti jepet studentit si dhe qëllimet akademike të programit ndonëse duhet të pasqyrohen më të plota në syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>Evidenca nr. 93 (tabela 14);</i></p> <p><i>Evidenca nr. 5.1;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 5.2;</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Çdo vit akademik, programet mësimore të akredituara i nështrohet procesit të rishikimit me qëllim përmirësimin e përmbajtjes dhe cilësisë. Ky proces përfshin në radhë të parë departamentet si njësitë bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit. Departamenti inicion vendimin për rishikimin e kurrikulës dhe përditësimin e programeve të lëndëve. Më tej vendimmarrja vijon në struktura të tjera.</p> <p>Titullarët e lëndëve të këtij programi studimi, çdo vit akademik reflektojnë ndryshime në programet e lëndëve në përshtatje me zhvillimet e reja të fushës që mbulon lënda. Departamenti gjithashtu ka realizuar kërkesa për blerje nga biblioteka të literaturës mbështetëse për lëndët mësimore me qëllim pasurimin e burimeve të literaturës.</p> <p><i>Evidenca nr 83;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 84;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 93 (tabela 14);</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në funksion të aktivitetit kërkimor shkencor të stafit akademik dhe studentëve është ngritur dhe funksionon biblioteka, pjesë e infrastrukturës së Universitetit “Epoka” me sipërfaqe prej 400m² dhe kapacitet 100 persona. Biblioteka ka një hapësirë dhe organizim të përshtatshëm që mundëson përdorimin në kushte optimale. Në kuadrin e të drejtave të tyre, studentët kanë të drejtën të përdorin infrastrukturën që Universiteti vë në dispozicion të procesit mësimor si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që institucioni ofron. Në këtë kuadër, ata kanë të drejtën e përdorimit në mënyrë të barabartë të mjediseve të bibliotekës dhe çdo shërbimi tjetër që ofrohet për realizimin e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 81 “Lista e fondit të bibliotekës”;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 85 “Informacion mbi shërbimet e bibliotekës”;</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka disponon një fond fizik prej 25000 librash ku përfshihet si literaturë në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhë të huaj. Në përbërje të fondit fizik të bibliotekës gjenden zhanre të ndryshëm si tekste mësimore, botime shkencore, revista shkencore periodike si dhe burime të tjera literature në përshtatje me nevojat kërkimore e shkencore.</p> <p>Pjesë e fondit fizik të bibliotekës është edhe literatura juridike prej 390 teksetesh në funksion të programit të studimit. Përveç fondit fizik, Universiteti “Epoka” ka mundësur akses në një sërë librarish dixhitale me një fond të pasur literature kryesisht në gjuhë të huaj. Biblioteka ka akses në sistemin JSTOR të biblioteka on-line i cili përfshin më shumë se 12 milion burime të literaturës, si tekste studimore, botime dhe artikuj shkencore në një sërë disiplinash shkencore. Biblioteka përdor gjithashtu sistemin KOHA, sistem dixhital i kërkimit dhe menaxhimit të literaturës.</p> <p><i><u>GVJ sugjeron pasurimin e mëtejshëm të fondit fizik të literaturës që i referohet programit të studimit me literaturë bashkëkohore në gjuhën shqipe.</u></i></p> <p><i>Evidenca nr. 81;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 82 “Lista e librave të rinj”;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 83 “Procedura mbi përdorimin dhe pasurimin e bibliotekës”;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 85;</i></p>

	<i>Evidenca nr.93 (tabela 17);</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	<p>Në funksion të procesit mësimor të këtij programi studimi, institucioni ka mundësuar akses në bibliotekë për të gjithë studentët e këtij programi. Shfrytëzimi i burimeve të bibliotekës, si i literaturës në gjuhë shqipe apo në gjuhë të huaj mundësohet në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë. Personeli përgjegjës garanton mundësinë e shfrytëzimit të burimeve të bibliotekës, pa dallim nga të gjithë studentët dhe personeli akademik për qëllime studimore dhe kërkimore. Sistemi JSTORE ofrohet falas nga institucioni për të gjithë studentët dhe stafin akademik.</p> <p><i>Evidenca nr. 81;</i> <i>Evidenca nr. 82;</i> <i>Evidenca nr. 85;</i></p>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	<p>Biblioteka ka një hapsirë të bollshme dhe organizim të përshtatshëm me qëllim shfrytëzimin në kushte maksimale të kapaciteteve të saj. Sistemi me raftë të hapura ku e gjithë literatura është e ekspozuar, lehtëson gjetjen dhe përdorimin e burimeve të fondit fizik të literaturës. Biblioteka ka një sallë leximi si dhe është e pajisur me kompjutera të cilët kanë të instaluar programe dhe sisteme elektronike të kërkimit të literaturës. Sistemi elektronik i kërkimit mundëson edhe akses në bibliotekat on-line. Aksesin në shtimin e bibliotekave dixhitale mund të realizohet nëpërmjet të dhënave zyrtare të logimit me të cilat janë të pajisur studentët dhe stafi akademik.</p> <p>Kjo mundëson akses e literaturës on-line jo vetëm në mjediset e bibliotekës, por edhe në distancë. Institucioni ka hartuar dokumentacion informues për studentët dhe kërkuesit ku parashikohet mënyrat, kushtet dhe rregullat e përdorimit të burimeve të bibliotekës si fizike, ashtu edhe asaj on-line.</p> <p><i>Evidenca nr. 83;</i> <i>Evidenca nr. 85;</i> <i>Evidenca nr. 86 "Rregullore e bibliotekës");</i></p>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje	<p>Shërbimi në biblioteka ofrohet në gjashtë ditë të javës (nga e hëna në të shtunë). Biblioteka qëndron e hapur dhe ofron shërbimin e saj në orarin 8:30 – 16:30. Gjatë këtij orari studentët mund të konsultojnë literaturën që lidhet me programin e studimit ose sistemin e librarive on-line. Orari i punës së</p>




<p>edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>bibliotekës bëhet i nohur nëpërmjet shpalljes në mjediset e institucionit.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Fondi fizik dhe ai on-line i bibliotekës përditësohen dhe pasurohen në vijëmbasi me literaturë bashkëkohore. Burimet e pasurimit të fondit të bibliotekës janë dhurimet dhe blerjet. Departamentet si dhe Përgjegjësi i Bibliotekës ndjekin ecurinë që i referohet fondin fizik dhe atij dixhital të bibliotekës si dhe nevojat për literaturë nga personeli akademik dhe studentet e programit. Blerja e librave të rinj realizohet kryesisht në bazë të kërkesave që vijnë nga Departamentet në funksion të nevojës për përditësimin dhe pasurimin e literaturës së programeve të studimit. Burimi kryesor kërkesave për pasurimin e fondit të bibliotekës janë edhe ato që përcillen nga Përgjegjësit e Departamenteve në përputhje me nevojat akademike e shkencore të personelit akademik. Studentët dhe përdoruesit e bibliotekës mund gjithashtu të iniciojnë një kërkesë për përditësimin e literaturës. Përditësimi i fondit të bibliotekës me literaturë bëhet edhe mbi bazën e donacioneve nga institucione apo individë. Institucioni ka hartuar manual ku përcaktohen kriteret dhe procedurat e pasurimit të bibliotekës, përfshirë edhe procedurat e dhurimeve.</p> <p><i>Evidenca nr. 82;</i> <i>Evidenca nr. 83;</i> <i>Evidenca nr. 84 "Vendim I Rektoratit mbi blerjen e librave");</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Stafi akademik vë në dispozicion të studentëve literaturën e detyrueshme si dhe atë të këshillueshme, (si një nga komponentët e syllabuseve të lëndëve), e cila është bashkëkohore dhe cilësore.</i></p> <p><i>Burimet e literaturës aksesohen në bibliotekë e cila ka një infrastrukturë mjaft të përshtatshme si dhe disponon një fond fizik të literaturës juridike dhe akses në libraritë on-line. Studentët dhe stafi akademik kanë të drejtën të e përdorimit të mjedisëve dhe shërbimeve të bibliotekës në përputhje me nevojat shkencore të realizimit të programit të studimit.</i></p>

	<i>GVJ sugjeron që fondi fizik i bibliotekës që i referohet këtij program studimi të pasurohet me literaturë në gjuhën shqipe në përputhje me nevojat e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Institucioni administrohet dhe menaxhon të dhënat e studentëve nëpërmjet një sistemi efikas të menaxhimit. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbajtjen dhe administrimin e regjistrave dhe çdo dokumentacioni që lidhet me procesin mësimor në këtë program studimit. Nga verifikimi i grupit të ekspertëve të jashtëm në Sekretarinë Mësimore u konstatua se regjistrat administrohen në përputhje me rregullimet e parashikura në legjislacionin në fuqi. Pranë Sekretarisë Mësimore referuar këtij program studimi, administrohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Regjistri themeltar i studentëve ku pasqyrohen të dhënat e studentëve në përputhje me kriteret ligjore; ● Regjistri i arritjeve akademike i cili pasqyron vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit; ● Regjistri i të diplomuarve që përmban të dhënat e studentëve që kanë përfunduar programin e studimit; <p>Regjistri bazë i studentëve plotësohet dhe administrohet në format të shkruar dhe elektronik. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave të studentëve realizohet në përputhje me kriteret e legjislacionin në fuqi, përfshirë edhe kriteret për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>Evidenca nr. 7;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 52, "Procedura mbi të dhënat e studentëve";</i></p> <p><i>Evidenca nr. 8;</i></p>

<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Institucioni ka ngritur dhe ka në funksion një sistem të brendshëm menaxhimi i cili mundëson administrimin e të gjithë dokumentacionit që i referohet burimeve njerëzore dhe aktivitetit të kryer në funksion të realizimit të programit të studimit. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për arkivimin e çdo dokumenti dhe të dhëne që i referohet studentëve dhe procesit mësimor. Ajo ruan dhe administron në format shkresor dhe elektronik dosjet personale të studentëve me rezultate e provimeve si dhe çdo dokumentacionin që i referohet atyre. Sekretaria Mësimore ruan dhe administron regjistrat si dhe dokumentacionin që i referohet procesit mësimor në format të shkruar dhe elektronik.</p> <p>Administrimi i të dhënave është dixhitalizuar nëpërmjet përdorimit të Epoka Interaktiv System EIS. Ky sistem mundëson informacion për çdo njësi administrative të përfshirë në programin e studimit. Ai është i aksesueshëm nga stafi administrativ dhe personeli akademik në varësi të nevojave dhe kompetencave të tyre.</p> <p><i>Evidenca nr. 88;</i> <i>Evidenca nr. 89 “Udhëzues I sistemit EIS për studentët”;</i> <i>Evidenca nr. 90 “Udhëzues I sistemit EIS për lektorët”;</i> <i>Evidenca nr 7 (dokumentacioni vizita në institucion);</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit EIS, Institucion menaxhon të gjithë informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me programin mësimor. Ky sistem mundëson dixhitalizimin e informacionit dhe një ndërveprim në kohë reale midis strukturave administrative dhe atyre akademike. Sistemi mund të aksesohet jo vetëm nga personeli akademik, por edhe nga studentët. Institucioni ka mundësuar hartimin e udhëzuesve të përdorimit për një përdorim dhe manxhim sa më efektiv të këtij sistemi.</p> <p><i>Evidenca nr. 88;</i> <i>Evidenca 89;</i> <i>Evidenca 90;</i> <i>Evidenca nr. 93 (tabela 17);</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka në përdorim një sistem të avancuar teknologjik dhe informatic nëpërmjet të cilit mundësohen shkëmbime të informacionit dhe komunikimit interaktiv dhe në kohë reale midis stafit akademik, atij administrative dhe</p>


<p>komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>studentëve. Institucioni përdor sistemin LMS me anë të të cilit aksesohen on-line materialet që i referohen programeve mësimore. Studentët dhe stafi akademik mund ta aksesojnë sistemin LMS nëpërmjet logimit me adresat zyrtare të emailit.</p> <p>Studentët dhe stafi akademik mund të përdorin gjithashtu sistemin EIS, sistem interaktiv i aksesueshëm gjithashtu me adresen zyrtare. Nëpërmjet këtij sistemi studenti mund të përzgjedhë lëndët, të verifikojë vlerësimet, pjesëmarrjen, detyrimet financiare apo të aksesojnë çdo të dhënë që i referohet programit mësimor. Njëkohësisht institucioni përdor sistemin Turnitin për verifikimin e origjinalitetit të punimeve shkencore.</p> <p><i>Evidenca nr. 88;</i> <i>Evidenca 89;</i> <i>Evidenca 90;</i> <i>Evidenca nr. 93 (tabela 17);</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit EIS mundësohet shkëmbimi në kohë reale i informacionit nëpërmjet një platforme dixhitale për personelin administrativ, stafin dhe studentët. Sistemi mundëson shkëmbimin dhe administrimin në një gamë të gjerë të informacionit nga të gjitha njësitë administrative, studentët dhe stafi akademik. Ky sistem i mundëson studentëve marrjen në kohë reale të informacionit që i referohet programit të studimit si pjesëmarrja, datat e provimeve, sistemi i vlerësimit etj.</p> <p>Sistemi përmban edhe informacione që i referohen programit të studimit dhe sillabuse të lëndëve. Njëkohësisht nëpërmjet këtij sistemi njësitë përkatëse administrative administrojnë informacion referuar burimeve njerëzore, aspekteve financiare apo elementëve të tjerë lidhur me programin e studimit. Ky sistem mundëson gjithashtu raportimin e të dhënave në kohë reale për organet përgjegjëse dhe autoritete drejtuese.</p> <p><i>Evidenca nr. 88;</i> <i>Evidenca nr. 89;</i> <i>Evidenca nr. 90;</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit</p>	<p>Informacionet që i referohen veprimtarisë akademike publikohen në faqen zyrtare të Universitetit Epoka eëë.epoka.edu.al. Kjo faqe përmban informacion të detajuar në lidhje me programet e studimit, personelin akademik si dhe</p>



në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	veprimtarinë e institucionit. Informacioni është i aksesueshëm si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën angleze. Informacion i dedikuar në lidhje me programin e studimit mund të aksesohet edhe në faqen web të Departamentit të Drejtësisë si njësi përgjegjëse për këtë program studimi www.law.epoka.edu.al .			
	<i>Evidenca nr.79;</i>			
Konkluzione	<i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i> <i>Institucioni administron dhe menaxhon të dhënat që i referohen këtij program studimi nëpërmjet një sitsemi efikas të menaxhimit. Ky sistem mundëson administrimin dhe monitorimin në kohë reale të informacionit në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor në këtë program studimi.</i> <i>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma të dedikuara për shkëmbimin e informacionit midis personelit akademik dhe studentëve si mënyra më e mirë për ritjen e aksesit në informacion.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni pasqyron gjendjen financiare të tij në përputhje me aktet e brendshme dhe rregulimet ligjore. Detyrimi për pasqyrimin e gjendjes financiare të institucionit për çdo program studimi është një detyrim statutor. Dekanati ka detyrimin statutor të hartojë dhe propozojë projekt buxheti vjetor të njësisë kryesore. Në kuadrin e hartimit të projekt buxhetit, njësitë bazë propozojnë dhe bëjnë kërkesa për fonde buxhetore lidhur me mbarëvajtjen e programit të studimit. Institucioni harton raporte financiare që i referohen ndarjes së burimeve financiare në nivel institucional ku përfshihen edhe planet e financimit të

	<p>programeve mësimore. Plani i financimit të Programit të Integrura të Ciklit të Dytë të Studimeve në Drejtësi, hartohet çdo vit akademik.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 14 “Autonomia dhe liria akademike dhe financiare”;</i></p> <p><i>Evidenca nr 87 “Plani I financimit të programit të studimit”;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 118 “Formulari për burimet njerëzore dhe nevojat infrastrukturore”;</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Në planin e financimit të Programit të Integrura të Ciklit të Dytë të Studimeve në Drejtësi pasqyrohen detaje që i referohen ndarjes së burimeve financiare në formën e shpenzimeve dhe të të ardhurave. Të ardhurat që i referohen programit të studimit gjenerohen nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare nga studentët, por edhe nga kontratat që rrjedhin nga veprimtaria kërkimore dhe grandet e përfituara.</p> <p>Statuti i Universitetit Epoka përcakton se ky institucion gëzon autonominë financiare. Autonomia financiare nënkupton edhe të drejtën për të përfituar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë që lidhen me mësimdhënien, pjesëmarrjen në projekte apo konsulenca. Plani financiar përmban edhe aspekte që lidhen me shpenzimet dhe investimet lidhur me mbarëvajtjen e programit.</p> <p>Në raportet financiare të institucionit detajohen të dhëna mbi shpenzimet financiare që i referohen pagave të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik, shpenzimet operative apo shpenzime të tjera në mbështetje të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 87;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 93 (tabela 18);</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare. Në përputhje me detyrimet statutores, institucioni harton buxhetin vjetor zbatimi i të cilit mbikqyret nga Bordi i Administrimit. Hartimi i projekt buxhetit bëhet në përputhje me standartet e vendosura nga aktet ligjore në fuqi.</p> <p>Performanca financiare e Universitetit Epoka, i nënshtrohet procesit të auditimit të brendshëm në përputhje me parashikimet</p>



	<p>e akteve të brendshme rregullatore. Institucioni zbaton gjithashtu edhe detyrimet që lidhen me vlerësimin e situatës financiare nëpërmjet auditimit të jashtëm. Auditimi i jashtëm i Universitetit Epoka kryhet si pjesë përbërëse e Shoqërisë Turgut Ozal Education SHA. Në raportet e auditimit të jashtëm pasqyrohet opinioni i audituesve të pavarur mbi pasqyrat e të dhënave financiare dhe performancën e shoqërisë Turgut Ozal Education SHA në tërësi.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 12;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 5 (dokumentacioni vizita në institucion) “Raportet e Auditit të Brendshëm dhe të Jashtëm”);</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Statuti parashikon që projekt buxheti vjetor hartohet nga Administratori edhe edhe mbi bazën e propozimeve që vijnë nga struktura të tjera, përfshirë edhe njësitë bazë.</p> <p>Strukturat përgjegjëse për administrimin financiar, informojnë mbi aspekte të realizimit të buxhetit që përfshijnë njësitë bazë përgjegjëse për programet e studimit. Hartimi i projektbuxhetin vjetor ndonëse realizohet në nivel institucional, merr për bazë edhe nevojat e njësisë bazë për fonde buxhetore. Institucioni informon njësitë bazë në lidhje me ecurinë e zbatimit të buxhetit të miratuar si dhe financimin e shpenzimeve që i referohen mbarëvajtjes së programit të studimit. <i>Evidenca nr. 1;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti Epoka e zhvillon veprimtarinë e tij në mjediset dhe mjetet e vëna në dispozicion nga Shoqëria “Turgut Ozal Education”, sh.a.</p> <p>Institucioni ka ngritur struktura të dedikuara të planifikimit, manxhimit dhe mbikqyrjes së veprimtarisë financiare me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë financiare. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ që mbikqyr qëndrueshmërinë financiare dhe administrative të institucionit. Ky Board kontrollon veprimtarinë e institucionit që lidhet me menaxhimin financiar dhe ekonomik, si dhe përdorimin e burimeve dhe asetëve të tij. Në përshtatje me çështjet që shtrihen për diskutim, në mbledhjet e Bordit mund të ftohen të marrin pjesë edhe ekspertë të fushave të ndryshme të brendshëm apo të jashtëm. Administratori i Universitetit është autoriteti më i lartë përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të Universitetit.</p>

	<p>Administratori mbikqyr zbatimin e buxhetit vjetor dhe në përfundim të çdo viti akademik i paraqet Bordit të Administrimit si dhe Senatit Akademik raportin vjetor mbi veprimtarinë financiare të Universitetit. Nga dokumentat e paraqitur nga institucioni rezulton se në planin financiar që i referohet programit të studimit pasqyrohet një balancë positive midis të ardhurave të përfituara dhe shpenzimeve të kryera për mbarëvajtjen e programit.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i> <i>Evidenca nr. 87;</i> <i>Evidenca nr. 7 (dokumentacioni vizita në institucion);</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare të tij në përputhje me aktet e brendshme dhe rregullimet ligjore. Ai zbaton gjithashtu edhe detyrimet që lidhen me vlerësimin e situatës financiare nëpërmjet auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm të veprimtarisë financiare.</i></p> <p><i>Institucioni harton raporte financiare që i referohen ndarjes së burimeve financiare në nivel institucional ku përfshihen edhe planet e financimit të programeve mësimore, përfshirë edhe planin e financimit të Programit të Integrura të Ciklit të Dytë të Studimeve në Drejtësi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Në aktet rregullatore të institucionit përcaktohen politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve. Në aktet normative të brendshme institucionale parashikohen në mënyrë të detajuar procedurat që mbulojnë të gjithë ciklin akademik edhe për Programin e Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi”. Rregullimet e brendshme normative janë në përputhje me kriteret e legjislacionit në fuqi në fushën e arsimit të lartë. Në rregulloret e brendshme ka parashikime që mbulojnë të gjithë ciklin akademik, procesin dhe komponentët e mësimdhënies si dhe diplomimin. Këto procedura janë hartuar dhe zbatohen në përputhje me parimet e institucionit si dhe strategjitë institucionale të zhvillimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i> <i>Evidenca nr. 49;</i> <i>Evidenca nr. 50;</i> <i>Evidenca nr. 7 (dokumentacioni vizita në institucion);</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e pranimit në programin e studimit janë transparente dhe bëhen të njohura publikisht. Gjatë ciklit akademik aktet rregullatore të institucionit kanë parashikime që mundësojnë barazi dhe trajtim të barabartë për të gjithë studentët e programit të studimit. Respektimi me rigorozitet i këtyre rregullimeve nga strukturat e institucionit dhe personeli akademik, mundëson respektimin e parimit të barazisë dhe garantimit të të drejtave në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët që ndjekin këtë program.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Pranimi dhe regjistrimi në programin e studimit bëhet në përputhje me rregullimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Aktet rregullatore të institucionit gjithashtu kanë përcaktuar kriteret e pranimit në varësi të ciklit të studimit dhe programit që Universiteti “Epoka” ofron. Kriteret të veçanta që i referohen këtij programi studimi parashikohen në rregulloren e këtij program dhe akte të tjera rregullatore. Institucioni publikon kriteret e pranimit përpara fillimit të çdo viti akademik në faqen web të tij. Disa nga kriteret e pranimit në këtë program</p>


	<p>studimi i referohen mbarimit me sukses të maturës shtetërore si dhe kriterit që lidhet me notën mesatare. Studentët që plotësojnë kushtet për tu regjistruar në këtë program duhet të plotësojnë edhe kriterin e veçantë të njohjes së gjuhës angleze sipas niveleve të caktuara nga vetë institucioni. Kuotat e pranimit propozohen nga Senati Akademik dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 13;</i></p> <p><i>Evidenca 50 "Vendim I Seantit Akademik në lidhje me kriteret e parnimit për vitin akademik 2023-2024";</i></p> <p><i>Evidenca nr. 7, (dokumentacioni vizita në institucion);</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Universiteti Epoka ka hartuar një bazë të gjerë rregullatore, përfshirë Statutin, rregulloret e brendshme si dhe akte të tjera normative të cilat dispijlojnë të gjitha spektet e jetës universitare. Në përmbajtjen e tyre ka parashikime mbi procedura dhe regullime që i referohen mbarëvajtjes së këtij program studimi. Aktet rregullatore parashikojnë kriteret e procedura të pranimit dhe regjistrimit të studentëve, mbarëvajtjes së procesit mësimor, vlerësimit të dijeve, transferimit të studimeve, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme etj. Gjuha e hartimit është e qartë dhe e kuptueshme. Pjesa kryesore e tyre botohen jo vetëm në faqen kryesore të Universitetit, (epoka.edu.al) por edhe në faqen web të Departamentit të Drejtësisë. Në këtë mënyrë i gjithë informacioni që lidhet me programin e studimit është lehtësisht i aksesueshëm nga publiku. Të interesuarit mund të njihen paraprakisht me këtë informacion, përpara regjistrimit në program, edhe nëpërmjet procesit të informimit i cili realizohet para fillimit të vitit akademik.</p> <p><i>Evidenca 1;</i></p> <p><i>Evidenca 13;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 45 "Procedurat e pranimit të studentëve";</i></p> <p><i>Evidenca 7 (dokumentacioni vizita në institucion);</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e</p>	<p>Përpara fillimit të vitit akademik institucioni merr masa paraprake dhe organizon aktivitete informuese mbi programet e studimit që ofron. Institucioni organizon ditët orientuese ku të ninteresuarit njihen me komponentët e programit të studimit,</p>



<p>përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>por edhe me aspektet organizative dhe administrative që i referohen programit. Programet e akreditura të studimeve shpallen publikisht para fillimit të aplikimit për pranime në to. Gjithashtu, bëhen publike edhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në programet që institucioni ofron.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 103 "Programi mbi sesionin orinetues për studentët");</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni zbaton politika për përzgjedhjen dhe trajtimin e studentëve me aftësi të veçanta. Këto politika janë në përputhje me legjislacionin në fuqi për trajtimin e personave me aftësi të veçanta. Politikat e zbatuara nga institucioni kanë si qëllim të mundësojnë krijimin e një ambienti ku të gjithë studentët kanë të drejtën e edukimit dhe pjesëmarrjes në kushte të barabarta. Për t'iu përgjigjur nevoja të studentëve me aftësi të veçanta Institucioni ka përcaktura në aktet e brendshme përgjegjësi konkrete si dhe struktura të dedikuara në këtë drejtim. Njëra prej tyre është edhe ekipi i aksesueshmërisë i cili i dedikohet trajtimit dhe mbështetjes së studentëve me aftësi të kufizuara.</p> <p><i>Evidenca nr. 56 "Politikat mbi studentët me aftësi të veçanta";</i></p> <p><i>Evidenca nr. 108 "Ekipi I aksesueshmërisë";</i></p> <p><i>Evidenca RVB;</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Statuti i Universitetit Epoka sanksionon mundësinë e ndjekjes së studimeve nga shtetas shqiptarë dhe të huaj, apo student sipas marëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe. Aktet regullatore të institucionit parashikojnë pranimin e studentëve të huaj nëpërmjet kuotave të caktuara nga Senati Akademik me propozim të fakulteteve. Në këto akte janë parashikuar edhe aspekte lidhur me kriteret dhe procedurat e regjistrimit. Aktualisht në këtë program studimi nuk ka regjistrime të studentëve të huaj.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 7;</i></p> <p><i>(dokumentacioni vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në</p>	<p>Institucioni ka një politikë të mbështetjes ekonomike për shtresat në nevojë nëpërmjet sistemit të bursave. Me anë të këtij sistemi institucioni mundëson ndihmë dhe mbështetje për një sërë kategorish të veçanta si studentët me aftësi ndryshe, fëmijet</p>

<p>programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>e policëve të vrarë në detyre, fëmijët jetimë apo me të ardhura ekonomike të ulta. Mbështetje mundësohet edhe për fëmijët e komuniteteve të tilla si ai rom, egyptian etj. Bursat që ofrohen nga Universiteti Epoka mundësojnë sipas rastit pagesën e plotë apo të pjesshme të tarifave të studimit. Sistemi i bursave shërben njëkohësisht edhe si një mjet nxitës për arritje të larta akademike nëpërmjet mbështetjes financiare që u mundësohet studentëve me rezultate të tilla.</p> <p><i>Evidenca 109 "Rregullorja mbi bursat e studimit";</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Universiteti Epoka ka hartuar një bazë të gjerë rregullatore, me të cilën disiplinon të gjitha spektet e jetës universitare. Në akte normative të brendshme institucionale parashikohen në mënyrë të detajuar procedurat që mbulojnë të gjithë ciklin akademik edhe për Programin e Integruar i Ciklit të Dytë në "Drejtesi".</i></p> <p><i>Në rregulloret e brendshme ka parashikime që mbulojnë të gjithë ciklin akademik, procesin dhe komponentët e mësimdhënies si dhe diplomimin. Rregullimet e brendshme normative janë në përputhje me kriteret e legjislacionit në fuqi në fushën e arsimit të lartë.</i></p> <p><i>Institucioni zbaton politika të të mbështetjes për shtresa të veçanta si personat me aftësi ndryshe apo shtresat në nevojë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e</p>	<p>Aktet e brendshme normative të institucionit kanë rregullime mbi të gjitha aspektet që lidhen me përparimin akademik të studentëve. Rregulloret që i referohen programit kanë parashikime mbi përmbajtjen e programit të studimit, procesin</p>



<p>përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>mësimor, frekuentimin dhe vlerësimin e dijeve. Për sa i takon pjesëmarrjes në procesin mësimor, studenti është i detyruar të ndjekë 75% të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore të zhvilluara në auditor si kusht për kualifikimin në lëndën/modulin.</p> <p>Rregullimet i referohen edhe aspekteve që lidhen me zhvillimin e provimeve, format e provimit të cilat mund të zhvillohen me gojë, me shkrim ose në formën e një projekti/detyre. Informacioni që lidhet me kriteret e përparimit akademik të studentëve është gjithashtu pjesë përbërëse e “Guidës së Studentit” e cila mund të aksesohet edhe në sitemin on-line.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i> <i>Evidenca nr. 13;</i> <i>Evidenca nr.78, Evidenca nr. 80;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Aspektet që lidhen me kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme si dhe transferimit të studimeve janë gjithashtu objekt i parashikimeve në aktet e brendshme rregullatore.</p> <p>Për sa i takon transferimeve, kuotat e transferimit në këtë program propozohen nga Departamenti i Drejtësisë dhe miratohen nga Dekanati. Rregullorja e programit të studimit parashikon kushtet dhe procedurat e transferimit të studimeve. Gjithashtu ka parashikime dhe procedura për njohjen e plotë apo të pjesshme të krediteve të fituara më parë nga studenti.</p> <p>Fakultetet e Universitetit Epoka kanë gjithashtu lirinë akademike të organizojnë programe të përbashkëta të studimeve ndërdisiplinore.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i> <i>Evidenca nr. 13;</i> <i>Evidenca nr. 47 “Direktiva mbi transferimin e studentëve”;</i> <i>Evidenca nr. 48 “Vendim mbi njohjen e kurseve dhe krediteve”;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit përmban një sërë parashikimesh mbi mënyrën e vlerësimit të dijeve, duke specifikuar kriteret e vlerësimit për leksionet, seminarët dhe projektet. Rregullime të detajuara sanksionohen edhe për sistemin tërësor të vlerësimit i cili përfshin vlerësimin e</p>

	<p>provimeve të mes-semesrit, fund-semester, detyrave të kursit, prezantimit dhe projekteve. Këto rregullime përfshijnë edhe mënyrën e konvertimit në sistemin shqiptar të vlerësimit. (pikëzimi koeficientët etj).</p> <p>Aktet rregullatore parashikojnë edhe aspekte rregullues te lidhur me kalueshmërinë, apo përmirësimin e mesatares së notave. Parashikime që lidhen me sistemin e vlerësimit janë gjithashtu pjesë e përmbajtjes së programit mësimor të çdo lënde/moduli. Gjatë procesit akademik studentët ndihmohen dhe orinetohen nga konsulenti akademik në procedurat që lidhen me procesin e mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca nr.2;</i> <i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.32;</i> <i>Evidenca nr.35;</i> Evidenca nr. 78; <i>Evidenca nr.114 "Lista e konsulentëve akademik të programit të studimit";</i> <i>Evidenca 7 (dokumentacioni shtesë);</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit janë objekt i rregullimit në aktet normative të brendshme. Rregulloret përkatëse si rregullorja e institucionit si dhe rregullorja që i referohet këtij programi studimi, parashikojnë procedurat, kushtet dhe kriteret që lidhen me punimin e diplomës, përzgjedhjen e temave, afatet e dorëzimit si dhe vlerësimin. Aspektet rregulluese përfshijnë edhe procesin e diplomimit. Parashikime të tilla janë edhe pjesë e dokumentave informues që iu dedikohen studentëve.</p> <p><i>Evidenca nr. 2;</i> <i>Evidenca nr. 7;</i> <i>Evidenca nr. 78;</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e</p>	<p>Rregullorja e institucionit si dhe rregullorja e programit të studimit përmbajnë informacion të plotë në lidhje me komponentët e programit të studimit. Gjithashtu informacion mbi lëndët dhe detyrimet akademike gjenden në Kurrikulën e Programit të Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë në "Drejtësi". Ky Informacion është lehtësisht i aksesueshëm pasi</p>

<p>studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>publikohet në faqen on-line të institucionit. Përpara fillimit të vitit akademik Institucion organizon veprimtari informuese ku bëhen të njohura programet e studimit si dhe struktura akademike dhe administrative në mbështetje të këtyre programeve. Në javën e parë të procesit mësimor studentët informohen nga stafi akademik mbi përmbajtjen dhe detyrimet për secilën lëndë.</p> <p><i>Evidenca nr. 2;</i> <i>Evidenca nr.4;</i> <i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr. 78;</i> <i>Evidenca nr. 103;</i></p>
---	---

<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, përfshirë, procedurat e pranimit të studentëve, transferimin dhe njohjen e krediteteve, procesin dhe komponentët e mësimdhënies si dhe diplomimin.</i></p> <p><i>Politikat, procedurat dhe kriteret e pranimit në programin e studimit si dhe zhvillimit të ciklit akademik janë transparente, bëhen të njohura publikisht dhe mundësojnë barazi dhe trajtim të barabartë për të gjithë studentët.</i></p> <p><i>Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika të mbështetjes ekonomike për shtresat në nevojë si dhe stimulimit të rezultateve të larta për studentët që ndjekin programin e studimit nëpërmjet sistemit të bursave.</i></p>
---------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët e këtij program studimi marrin informacion të detajuar mbi komponentët e programit nëpërmjet një sërë burimesh si pedagogu i lëndës, Sekretaria Mësimore, aketet rregullatore apo informacionet e publikuara nga institucioni. Në fillim të vitit akademik studentët informohen nga pedagoët e lëndës në lidhje me përmbajtjen dhe detyrimet e lëndës. Informacion i detajuar gjendet edhe në Kurrikulën e Programit të Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë në “Drejtësi”. Informacioni mund të akseohet edhe nga dokumente të dedikuara studentëve si “Guida e Studentit” e cila përmban informacion mbi të gjitha aspektet infrastrukurore, administrative dhe akademike që i referohen programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca nr.4;</i> <i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.78;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët e marrin këtë informacion në Kurrikulën e Programit të Integruar të Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” si dhe rregulloren e posaçme mbi këtë cikël studimesh. Njëkohësisht në syllabuset e lëndëve gjendet informacion mbi përmbajtjen e lëndëve, objektivat formues si dhe format e vlerësimit të njohurive. Programet e lëndeve publikohen online jo vetëm në faqen web të institucionit, por edhe atë të Departamentit. Studentët aksesojnë informacion edhe nëpërmjet platformave të krijuara si sistemi LMS, apo EIS, me anë të të cilave informacioni aksesohet në kohë reale dhe në distancë. Pedagogët e lëndës përdorin edhe platforma të tjera si Google Classrooms me të cilat studentët aksesojnë materialet apo literaturën e lëndës.</p> <p><i>Evidenca nr.2;</i> <i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.5.1 & 5.2;</i> <i>Evidenca nr. 32;</i> <i>Evidenca nr. 93 (tabela 17);</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen</p>	<p>Institucioni ka politika dhe struktura me të cilat mbështet dhe orienton studentët drejt tregut të punës. Kohëzgjatja e praktikës profesionale si dhe marrëveshjet e lidhura me institucionet private dhe shtetërore për zhvillimin e praktikës janë një premisë</p>




<p>institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>për mundësitë e punësimit të studentëve. Me qëllim mbështetjen institucionale dhe orintimin drejt tregut të punës, janë krijuar struktura të dedikuara si Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni. Njoftimet që i referohen mundësive për punësim publikohen në faqen e internetit të kësaj zyre, duke mundësuar akses të gjerë për të gjithë studentët. Kjo zyrë organizon, evente dhe aktivitete që nxisin drejt mundësive të punësimit për studentët. Panairi i karrierës është një nga aktivitetet më të rëndësishëm në këtë drejtim ku mundësohet pjesëmarrja e mbi 100 bizneseve dhe kompanive.</p> <p><i>Evidenca nr. 9;</i> <i>Evidenca nr.11;</i> <i>Evidenca RVB;</i> <i>Evidenca nr.93, (tabela 5);</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët mund ta aksesojnë këtë informacion që në momentin e parë të regjistrimit, nëpërmjet veprimtarive orientuese apo informuese që organizon institucioni. Sekretaria mësimore u jep studentëve çdo informacion të nevojshëm mbi organizimin e procesit mësimor. Zyrat e Informacionit gjithashtu orineton studentët mbi aspektet që lidhen me procesin mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të tij.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka hartuar dhe vë në dispozicion të studentëve udhëzues të posaçëm që i referohen programit të studimit. Këto dokumenta përmbajnë informacion mbi programin e studimit si dhe logjistikën dhe infrastrukturën në funksion të tij.</p> <p><i>Evidenca nr. 78;</i> <i>Evidenca nr. 103;</i> <i>Evidenca nr. 114 “Elementët e programit mësimor”;</i> <i>Evidenca nr. 116 “Kalendari akademik 2022-2023”);</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nëpërmjet platformave dixhitale të komunikimit, institucioni mundëson një sistem efikas të menaxhimit të informacionit. Një sërë paltformash në funksion të studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ si sistemi LMS, sistemi interaktiv EIS etj mundësojnë që informacioni të jetë lehtësisht i arritshëm edhe në distancë. Studentët dhe stafi akademik orintohen mbi</p>

	<p>përdorimin e platformave me qëllim lehtësimin e aksesimit të informacionit.</p> <p><i>Evidenca nr. 76;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 88;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 89;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 90;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Universiteti “Epoka” zotëron kapacitetet e nevojshme për tu mundësuar studentëve të këtij program informacion mbi komponentët e programit të studimit. Studentët informohen jo vetëm mbi përmbajtjen e programit mësimor, por edhe mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të programit të studimit.</i></p> <p><i>Informacioni u vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet strukturave të dedikuara. Ky informacion mund të aksesohet edhe nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit me anë të përdorimit të platformave dhe sistemeve dixhitale të komunikimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Universiteti “Epoka” nëpërmjet strukturave të tij, disponon dhe administron statistika vjetore mbi numrin e studentëve të diplomuar. Në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi si dhe ato të akteve rregulatore të institucionit, Sekretaria Mësimore administron një regjistër të veçantë, regjistrin e të diplomave i cili përmban të dhënat të e studentëve që kanë përfunduar me sukses programin e studimit dhe janë diplomuar. Ky program

	studimi është në proces dhe studentët e parë do të diplomohen në fund të vitit akademik 2022-2023.																												
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Në kuadrin e kompetencave të saj, Sekretaria Mësimore administron dokumentacionin me të dhënat e studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p> <p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është sim ë poshtë vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr i të regjistruarve</th> <th>Nr i të cregjistruarve</th> <th>Nr aktual</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>20</td> <td>3</td> <td>17</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>15</td> <td>7</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>23</td> <td>5</td> <td>18</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>23</td> <td>5</td> <td>18</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>20</td> <td>0</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td colspan="3">81 studentë</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga vëzhgimi i kryer pranë Sekretarisë Mësimore rezultoi se në të dhënat e administruara pasqyrohen elementë që i referohen numrit të studentëve që ndjekin programin e studimit për çdo vit akademik, tërheqjet nga programi apo largimet para përfundimit të programit. Për sa i takon transferimeve nga institucione të tjera brenda ose jashtë vendit, nuk ka studentë të transferuar në këtë program studimit. Studentët që përfundojnë me sukses këtë program studimit do të diplomohen në përfundim të vitit akademik 2022-2023.</p> <p><i>Evidenca nr. 2 "Cilësia e studentëve në hyrje dhe dalje";</i></p> <p><i>Evidenca nr. 75;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 93 (tabela 21);</i></p>	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të cregjistruarve	Nr aktual	2018-2019	20	3	17	2019-2020	15	7	8	2020-2021	23	5	18	2021-2022	23	5	18	2022-2023	20	0	20	Totali	81 studentë		
Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të cregjistruarve	Nr aktual																										
2018-2019	20	3	17																										
2019-2020	15	7	8																										
2020-2021	23	5	18																										
2021-2022	23	5	18																										
2022-2023	20	0	20																										
Totali	81 studentë																												
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të gjitha të dhënat statistikore që u referohen studentëve administrohen jo vetëm në format dokumentar, por edhe elektronik. Këto të dhëna regjistrohen edhe në sitemin e brendshëm interaktiv të menaxhimit të informacionit, sitemin EIS. Ky informacion administrohet nga strukturat kompetente</p>																												



	<p>në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar.</p> <p><i>Evidenca nr. 76;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 77;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 8;</i></p> <p><i>(dokumentacioni shtesë);</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Institucioni realizon kontrole periodike pranë sekretarisë mësimore si dhe strukturave të tjera përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e brendshëm të informacionit në lidhje me studentët dhe procesin mësimor. Kontrole sistematike pranë njësive akademike dhe administrative të Universitetit realizohen edhe në kuadrin e procesit të auditit të brendshëm në nivel institucional. Për këtë qëllim në nivel institucional ngrihet dhe funksionon Grupi i Auditit të Brendshëm. Rezultatet e kontroleve janë pjesë e raportimeve dhe u referohen strukturave përkatëse me qëllim marjen e masave konkrete për përmirësimin e problematikave të evidentuara.</p> <p><i>Evidenca nr. 110;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 111;</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Sekretaria Mësimore administron të dhënat e studentëve si dhe dokumentacionin mbi numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit për çdo vit akademik. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore administron të dhëna që i referohen cilësisë së studentëve në hyrje në fazën e regjistrimit në këtë program studimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet një nivel i lartë i notës mesatare në hyrje e cila varion nga 8.3/10-8.96/10.</p> <p>Për sa i takon cilësisë së studenteve gjatë procesit mësimor, Departamenti i Drejtësisë harton raporte analitike që i referohen pjesëmarjes dhe rezultateve të vlerësimit të studentëve në secilën lëndë. Në këto raporte pasqyrohen edhe komentet dhe konkluzionet që rezultojnë nga këto të dhëna. Këto raporte shërbejnë si një premisë mbi analizat që i referohen cilësisë së mësimdhënies dhe marjen e masave për përmirësimin e treguesve të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca nr. 2 (dokumentacioni vizita në institucion);</i></p>

	Evidenca 3 (dokumentacioni vizita në institucion) "Rezultatet e vlerësimit të kursit";			
	Evidenca 93 (tabela 21);			
Konkluzione	<p>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</p> <p><i>Institucioni disponon dhe administron të dhëna mbi numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi. Institucioni harton statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit, deri në diplomimin e tyre. Nëpërmjet këtyre të dhënave hartohen edhe raporte analitike në lidhje me cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje.</i></p> <p><i>Këto të dhëna administrohen në formë dokumentare si dhe sitemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Strukturat kompetente kontrollojnë periodikisht administrimin dhe menaxhimin e brendshëm të dokumentacionit në lidhje me studentët dhe procesin mësimor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Statuti i Universitetit Epoka parashikon të drejtën e studentëve për të marrë pjesë në proceset e vendimarrjes së Universitetit në përputhje me rregullime të Statutit dhe aktet rregullore të institucionit. Statuti specifikon mekanizmat dhe procedurat e përfshirjes së studentëve në proceset vendimarrëse në nivel institucional.</p> <p>Organizimi në shoqata studentore si dhe këshilla studentore është pjesë e katalogut të të drejtave të studentëve. Këshilli Studentor është një organizëm i pavarur i cili kordinon pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e studentëve në organet drejtuese</p>


	<p>të Universitetit Epoka. Këshilli Studentor shpreh mendimin dhe bën propozime për çështje me interes të përgjithshëm të Universitetit, përfshirë edhe planet dhe programet e studimeve. Një pjesë e anëtarëve të Këshillit përfaqësohen në organe të rëndësishme vendimarrëse në rang institucional. Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit të Studentëve janë anëtarë të Senatit Akademik. Studentët përfaqësohen gjithashtu edhe në Këshillin e Etikës si dhe në komisionet e përhershme në nivel institucional. Në nivel institucional është ngritur dhe funksionon Komisioni i Përhershëm për Marëdhëniet me Studentët.</p> <p><i>(Evidenca nr. 1;</i> <i>Evidenca nr. 55;</i> <i>Evidenca nr. 57;</i> <i>Evidenca nr. 7;</i> <i>(dokumentacioni vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët përfaqësohen në organet më të rëndësishme vendimarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë si dhe Komisioni i Përhershëm për Marëdhëniet me Studentët. Ky Komision përveç Koordinatorit dhe Zëvendëskordinatorit të studentëve ka në përbërje edhe dy studentë të zgjedhur nga Këshilli i Studentëve. Koordinatorin e studentëve është edhe Kryetari i Komisionit. Me një përfaqësim të gjerë të studentëve ky organizëm rekomandon politikën në lidhje me veprimtarinë në të gjitha aspektet e jetës studentërore.</p> <p>Përfshirja e studentëve në organet vendimarrëse të institucionit u mundëson atyre të përfaqësojnë qëndrimin e studentëve mbi procesin akademik dhe jetën universitare. Studentët e shprehin qëndrimin dhe vlerësimin e tyre edhe nëpërmjet pyetësorëve të cilët realizohen në mënyrë sistematike dhe vlerësojnë aspekte të procesit të mësimdhënies, infrastrukturës dhe administrimit të programit mësimor.</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i> <i>Evidenca nr.2;</i> <i>Evidenca nr.7;</i> <i>Evidenca nr. 31;</i> <i>Evidenca nr.55;</i></p>

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Në kuadrin e të drejtave të tyre, Statuti ka sanksionuar të drejtën e studentëve të shprehin vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e personelit akademik. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në kuadrin e kompetencave të saj në fund të çdo semesri, para sezonit të provimeve, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo lëndë të programit të studimit. Këto pyetësore shërbejnë më tej në procesin e vlerësimit të cilësisë si dhe në vendimmarjen e Departamentit mbi aspekte që lidhen me programin e studimit</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 27;</i></p> <p><i>Evidenca 31;</i></p> <p><i>Evidenca nr 37;</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregulloret e brendshme të institucionit dhe të programit të studimit sanksionojnë të drejtën e studentëve të shprehin qëndrimin e tyre mbi procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentet kanë të drejtën të shprehen në lidhje me procedurën si dhe shkallën e vlerësimit të dijeve të tyre nëpërmjet sistemit të ankimimit. Aktet rregullatore parashikojnë të drejtën e ankimimit si një nga të drejtat bazike të studentëve, si dhe detajojnë procedurat e zbatimit në praktikë. Për këtë qëllim aktet e brendshme institucionale parashikojnë një sërë rregullimesh mbi sistemin e ankimimit, afatet si dhe organet ku mund të drejtohet ankesa. Institucioni ka ngritur një strukturë të dedikuar në këtë drejtim, Bordin e Provimeve. Gjatë takimit të zhvilluar me studentët nga GVJ u konstatua se studentët e kanë ushtruar të drejtën e ankimit kryesisht në lidhje me rezultatet e provimeve.</p> <p><i>Evidenca nr. 2;</i></p> <p><i>Evidenca nr.7;</i></p> <p><i>Evidenca nr.13;</i></p> <p><i>Evidenca nr.36;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 40 “Formulari I ankimit të notës”;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 42 “Vendim I Dekanatit mbi ankimin e notës”;</i></p> <p><i>Evidenca nr.72 “Mbi raportin e bordit të provimeve”, Evidenca nr.106);</i></p>


Konkluzione	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Universitetit Epoka garanton të drejtën e studentëve për të marrë pjesë në proceset vendimmarëse të Universitetit nëpërmjet përfaqësimit në organet më të rëndësishme në nivel institucional.</i></p> <p><i>Pëfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse të institucionit u mundëson atyre të përfaqësojnë qëndrimin e studentëve mbi procesin akademik dhe jetën universitare.</i></p> <p><i>Studentët e shprehin qëndrimin dhe vlerësimin e tyre edhe nëpërmjet pyetësorëve të cilët realizohen në mënyrë sistematike dhe vlerësojnë aspekte të procesit të mësimdhënies, infrastrukturës dhe administrimit të programit mësimor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Statuti i Universitet dhe aktet e brendshme rregullatore kanë parashikuar struktura dhe procedura në funksion të informimit të studentëve. Struktura të tilla janë Sekretaria Mësimore, dhe Departamenti si njësi përgjegjëse për administrimin e procesit akademik që i referohet këtij program studimi. Një sërë strukturash të tjera janë gjithashtu në funksion të informimit dhe mbështetjes ndaj studentëve. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni informon dhe orienton studentët mbi mundësitë e tregut të punës dhe të punësimit. Deakni i Studentëve luan një rol mjaft të rëndësishëm si një strukturë dedikuar ndaj studentëve. Në kuadrin e kompetencave të saj, zyra e Dekanit të Studentëve pranon dhe trajton kërkesat e studentëve në lidhje me aspekte të jetës akademike dhe administrative.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i></p>

	<p><i>Evidenca nr.7;</i></p> <p><i>Evidenca nr.59;</i></p> <p><i>Evidenca nr.106;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Universiteti Epoka ka struktura të dedikura për ndjekjen dhe asistimin e studentëve si dhe një sistem menaxhimi për ofrimin e informacionit mbi procesin mësimor dhe programin e studimit. Pranë Departamentit të Drejtësisë, studentëve të këtij program studimi u mundësohet këshillimi dhe orientimi nga konsulentë akademik gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së studimeve. Drejtuesi i Departamentit është njëkohësisht edhe Koordinatori i Programit të Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë në Drejtësi.</p> <p>Stafi administrativ dhe zyrat e dedikuar si Dekani i Studentëve gjithashtu mbështesin dhe asistojnë studentët në çështje të administrimit të procesit mësimor. Studentët marrin informacion edhe nëpërmjet aksesit në sistemin e menaxhimit të informacionit dhe përdorimit të platformave të tilla si EIS, LMS etj. Institucioni ka hartuar udhëzues të posaçëm për informimin e studentëve mbi të gjitha aspektet e jetës akademike.</p> <p><i>Evidenca nr. 13;</i></p> <p><i>Evidenca nr.20;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 78;</i></p> <p><i>Evidenca nr.79;</i></p> <p><i>Evidenca nr.9;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 114 “Lista e këshilltarëve për vitin akademik 2022-2023”);</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë ku ofrohet ky program studimi mundëson për studentët këshillim dhe orientim gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit mësimor. Këshilltarët akademikë të cilët janë personel akademik me kohë të plotë orientojnë dhe informojnë studentët mbi aspekte që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe përparimin akademik të tyre. Më qëllim mbështetjen reale të studentëve, këshilltarët akademikë si rregull mbështesin një ose një grup të vogël studentësh.</p> <p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumini orientojnë studentët në tregun e punës si dhe zhvillimin e karrierës. Nëpërmjet marrëdhënieve të bashkëpunimit me biznese, institucione private</p>



<p>tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>e shtetërore kjo zyrë mundëson krijimin e oportuniteteve të punësimit. Zyra i ndihmon dhe mbështet studentët në procesin e kërkimit të punës dhe punësimit nëpërmjet trajnimeve profesionale. Kjo Zyrë mban gjithashtu lidhjet me studentët edhe pas diplomimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 11;</i></p> <p><i>Evidenca 114;</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Institucioni ka ngritur Zyrën e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë, nja nga kompetencat e të cilës është kryerja e studimeve gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe vlefshmërinë e programeve të studimit të ofruara nga institucioni. Gjithashtu nëpërmjet sistemit të gjurmimit të studentëve ALUMNI është mundësuar edhe marrja e mendimit të tyre në lidhje me cilësinë e programeve të studimit ku janë diplomuar nëpërmjet sondazheve ALUMNI. Sondazhe të tilla ende nuk janë realizuar në këtë program studimi pasi nuk nuk ka një brez të dilomuariss.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i></p> <p><i>Evidenca nr.95;</i></p> <p><i>Evidenca nr.104;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Universiteti Epoka ka struktura të dedikuara për këshillimin, asistimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve si dhe një sistem menaxhimi për ofrimin e informacionit mbi procesin mësmor dhe programin e studimit. Strukturat kompetente orientojnë studentët në tregun e punës si dhe zhvillimin e karrierës. Këto struktura ndjekin në vazhdimësi karrierën e studentëve të diplomuar nëpërmjet kontakteve edhe pas diplomimit.</i></p> <p><i>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” akreditohet për herë të parë dhe studentët e këtij progami diplomohen në vitin akademik 2022-2023.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Rritja e cilësisë së mësimdhënies është një nga prioritetet strategjike në nivel institucional. Në strategjinë zhvillimore të institucionit pasqyrohet angazhimi i Universiteti Eopoka për të përmirësuar cilësinë dhe teknikat e mësimdhënies. Për këtë qëllim Universiteti angazhohet në realizimin e procesit të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjive inovative dhe metodave kreative të mësimdhënies. Në këtë mënyrë nxitet eksperiencia pozitive në procesin e të nxënit tek studentët.</p> <p>Në kaudrin e prioriteteve strategjike rëndësi i kushtohet aktiviteteve trajnuese me stafin akademik në fushën e mësimdhënies dhe metodave të mësimdhënies në përputhje edhe me specifikat e programit të studimit. Për të mundur kualifikimin e vazhdueshëm të stafit në fushën e aftësive dhe metodologjive të mësimdhënies, institucioni ka mundur një sërë aktivitesh të tilla.</p> <p><i>Evidenca nr.12;</i> <i>Evidenca nr.18;</i> <i>Evidenca nr.19;</i> <i>Evidenca nr.43;</i> <i>Evidenca RVB;</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe</p>	<p>Aktet regullatore të institucionit kanë parashikuar ngritjen e strukturave përgjegjëse për kontrollin e cilësisë së mësimdhënies. Sigurimi brendshëm i cilësisë është detyrë e Senatit Akademik i cili ngre Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Struktura të sigurimit të cilësisë janë Zyra e Sigurimit</p>

<p>inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë etj. Këto struktura në kuadrin e mbikqyrjes së cilësisë, monitorojnë cilësinë e mësimdhënies gjatë procesit akademik. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson një herë në vit efikasitetin e veprimtarive mësimore kërkimore, financiare dhe administrative të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale pjesë e të cilit është edhe Departamenti i Drejtësisë.</p> <p><i>Evidenca 27;</i> <i>Evidenca nr.43;</i> <i>Evidenca 7;</i> <i>(dokumentacioni vizita në institucion);</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Vlerësimi i metodave dhe aftësive të mësimdhëniesë të stafit akademik është pjesë përbërëse e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë. Institucioni vlerëson në fund të çdo semestri cilësinë e çdo program/moduli si dhe aftësinë e mësimdhënies. Institucioni ka ngritur një sërë mekanizmesh të vlerësimit të cilësisë ku mundësohet edhe përfshirja dhe shprehja e opinionit të studentëve.</p> <p>Instrumenti kryesor në këtë drejtim janë pyetësorët e vlerësimit të modulit të studentëve, një pjesë e mirë e përmbajtjes së të cilëve i referohet procesit të mësimdhënies. Në këto sondazhe studentët japin komentet dhe vlerësimet e tyre mbi aspekte të procesit të mësimdhënies si niveli i përgatitjes dhe njohurive, aftësia dhe metodat e mësimdhënies.</p> <p>Në përfundim të çdo viti akademik institucioni realizon gjithashtu edhe sondazhet ALUMINI. Një tjetër mekanizëm është edhe sistemi i ankimimit i cili i referohet jo vetëm vlerësimit të dijeve, por edhe çdo aspekti tjetër që lidhet me procesin akademik.</p> <p><i>Evidenca nr.2;</i> <i>Evidenca nr. 29;</i> <i>Evidenca nr.30;</i> <i>Evidenca nr.31;</i> <i>Evidence nr. 36;</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin</p>	<p>Institucioni përdor një sërë mekanizmesh të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies si sondazhet e studentëve, sondazhet</p>



<p>dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>ALUMNI, vlerësimi nga eprori, monitorimi nga Departamenti etj. Rezultatet që vijnë nga proceset e vlerësimit të cilësisë janë pjesë e raporteve që i referohen veprimtarisë së strukturave akademike në kuadrin e sigurimit të cilësisë. Si të tilla këto raporte si dhe rezultate e vlerësimit i bëhen të njohura stafit akademik. Njëkohësisht edhe studentët kanë të drejtë të njihen me konkluzionet dhe rekomandimet që rezultojnë nga procesi i anketimit si dhe masat e marra në këtë drejtim. Raporte e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe raportet e njëjësive të ngarkuar me mbikqerjen dhe vlerësimin e cilësisë bëhen publike në faqen web të institucionit.</p> <p><i>Evidenca 27;</i> <i>Evidenca 31;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni përdor mekanizma të vlerësimit të performancës akademike dhe veprimtarisë administrative të stafit të përfshirë në programin e studimit. Për këtë qëllim janë hartuar direktiva të posaçme mbi kriteret dhe mekanizmat e vlerësimit të performancës si dhe janë ngritur struktura të posaçme si Bordi i Vlerësimit të Përfundimit Akademik dhe Vlerësimit të Cilësisë si dhe Bordi i vlerësimit të Performancës Administrative dhe Vlerësimit të Cilësisë. Në përmbajtjen e direktivave janë parashikuar aspekte që i referohen nxitjes së përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe promovimit të praktikave më të mira në vlerësimin e performancës së personelit akademik. Vlerësimi i performancës që i referohet cilësisë së mësimdhënies stimulohet nëpërmjet mekanizmave shpërblyes që caktohen nga Bordi i Administrimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 28 "Direktiva mbi vlerësimin e performancës akademike dhe administrative dhe përmirësimin e cilësisë", Evidenca nr. 29;</i> <i>Evidenca 30;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Rritja e cilësisë së mësimdhënies është një nga prioritetet e strategjive zhvillimore të institucionit. Universiteti Epoka ka ndërmarë masat e nevojshme në realizimin e procesit të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjive inovative dhe metodave kreative të mësimdhënies. Aktet regullatore të institucionit kanë parashikuar ngritjen e strukturave përgjegjëse</i></p>

	<p><i>për kontrollin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni përdor një sërë mekanizmesh të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies si sondazhet e studentëve, sondazhet ALUMNI, vlerësimi nga eprori, monitorimi nga Departamenti etj.</i></p> <p><i>Nëpërmjet mekanizmave stimulus, institucioni nxit përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe promovimin e praktikave më të mira në vlerësimin e performancës së personelit akademik.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Universiteti Epoka e ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në Statutin, aktet rregullatore si dhe Ligjin nr.80/2015 dt. 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i komponentëve të saj është pjesë e objektivave zhvillimore të Universitetit. Universiteti Epoka pasqyron politikat e tij të sigurimit të cilësisë në dokumenta ku parashikohen parimet dhe standartet e sigurimit të cilësisë.</p> <p>Rektorati harton planin strategjik të zhvillimit të Universitetit si dhe ndjek zbatimin e tij. Në nivel të njëjësive bazë, hartimi planit strategjik të këtyre njësive është pjesë e kompetencave të Dekanatit. Të gjitha strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë duhet të konsiderojnë standartet, parimet dhe objektivat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional. Senati Akademik i këtij universiteti garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë, vendos për krijimin e Komisionit të Përherëshëm për Sigurimin e Cilësisë dhe miraton paltformën e punë së tij.</p> <p>Komisioni i Përherëshëm për Sigurimin e Cilësisë është organi përgjegjës në nivel institucional për hartimin e politikave dhe</p>

	<p>standarteve për sigurimin e cilësisë si dhe mbikqyrjen e zbatimit të këtyre politikave. Një tërësi strukturash të tjera janë përfshirë në procesin e politikbërjes, vlerësimi periodik dhe mbikqyrjes së cilësisë.</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i> <i>Evidenca nr. 12;</i> <i>Evidenca nr. 7;</i> <i>Evidenca nr. 111 “Politikat e cilësisë”;</i> <i>(dokumentacioni vizita në institucion);</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të komponentëve kryesore të cilësisë, Institucioni ka hartuar Strategjinë Zhvillimore duke mundësuar edhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve. Njëkohësisht ka hartuar udhëzues të posaçëm për sigurimin e cilësisë ku pasqyrohen vizioni dhe misioni i Institucionit në sigurimin e cilësisë si dhe parimet dhe metodat për sigurimin e cilësisë. Udhëzuesi detajon organizimin strukturor të sistemit të sigurimit të cilësisë, organet përgjegjësie, kompetencat dhe procedurat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë. Në nivel institucional është ngritur dhe funksionon një sistem efikas i sigurimit të brendshëm të cilësisë. Një sërë organizmash ushtrojnë kompetencat e tyre me qëllim garantimin e cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit që ofron ky institucion. Senati Akademik është organi më i lartë administrative që ushtron kompetenca për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me standartet shtetërore.</p> <p>Në nivel institucional është ngritur Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë ku marrin pjesë edhe përfaqësues të studentëve dhe ekspertë të jashtëm si dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Organizma të tjerë janë edhe Bordi i Provimeve, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, si dhe Bordi I Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Përmirësimit të Cilësisë.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i> <i>Evidenca nr. 12;</i> <i>Evidenca nr. 43 “Udhëzues për sigurimin e cilësisë”;</i> <i>Evidenca nr. 44 “Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e KPSC;</i></p>



<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sigurimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë është pjesë e strategjisë institucionale si dhe planeve të veprimit në nivel institucional. Në kuadrin e vlerësimit të cilësisë, Universiteti “Epoka” ka zbatuar procedurat e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit në përputhje me rregullimet ligjore. Universiteti ka respektuar detyrimet ligjore që lidhen me aplikimin për akreditimin institucional pranë ASCAL. Institucioni ka kryer akreditimin institucional në vitin 2021, në bazë të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 54, datë, 16.12.2021.</p> <p>Njëkohësisht programet e studimit që ofron institucioni i janë nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike dhe krahasuese si dhe proceseve që përmirësojnë cilësinë. Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në Drejtësi ka kaluar në procesin e vlerësimit të brendshëm realizuar nga institucioni. Ky program është në proces të vlerësimit të jashtëm me qëllim akreditimin e parë, dhe më tej do ti nënshtrohet vlerësimit periodik.</p> <p><i>Evidenca nr. 75, “Raporti institucional vjetor 2021-2022”;</i> <i>Evidenca 100 “Shkresë për kodifikimin e programeve të studimit”;</i> <i>Evidenca RVB;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar tregues që identifikojnë cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe përcaktojnë arritjet më të mira dhe mangësitë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Programet mësimore i nënshtrohen vlerësimit të brendshëm të cilësisë, rezultatet e të cilave duhet të bëhen publike. Aktet rregullatore të institucionit i japin një hapsirë të gjerë procesit të kërkimit shkencor dhe integritetit të tij në procesin e mësimdhënies në funksion të rrijës së cilësisë së mësimdhënies. Statuti sanksionon kërkesën që procesi i kërkimit të sigurojë integritetin e kërkimit me mësimin. Veprimtaria kërkimore shkencore zhvillohet mbi bazën e planeve dhe projekteve të miratuara nga njësi bazë dhe kryesore. Performanca e punës kërkimore vlerësohet në promovimin e personelit akademik edhe nëpërmjet stimulave financiarë.</p> <p><i>Evidenca nr. 28;</i> <i>Evidenca nr. 29;</i> <i>Evidenca nr. 30;</i></p>

	<p><i>Evidenca nr 31;</i> <i>Evidenca nr.63;</i> <i>Evidenca nr.64;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i komponentëve të saj është pjesë e objektivave zhvillimore të Universitetit. Në nivel institucional është ngritur dhe funksionon një sistem efikas i sigurimit të brendshëm të cilësisë. Sigurimi i cilësisë mundësohet nga një sërë strukturash të cilat nëpërmjet kompetencave të tyre garantojnë cilësinë institucionale dhe të programeve të studimit që ofron ky institucion.</i></p> <p><i>Në kuadrin e vlerësimit të cilësisë, Universiteti ka zbatuar procedurat lidhur me vlerësimin e brendshëm dhe vlerësimin e jashtëm institucional dhe të programve të studimit. Programi i Integruruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në Drejtësi ka kaluar në procesin e vlerësimit të brendshëm realizuar nga institucioni. Ky program është në proces të vlerësimit të jashtëm.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
				X

Standardi VL3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe	Përmirësimi i cilësisë së programit të studimit është një nga misionet më të rëndësishëm në nivel institucional. Në kuadrin e politikave të vlerësimit të cilësisë institucioni përdor një sërë metodash e procesh për vlerësimin e cilësisë së programeve që ofron. Vlerësimi i cilësisë së programit realizohet në mënyrë sistematike nëpërmjet proceseve që i shërbejnë rritjes së efektivitetit të tij. Ky proces përfshin një sërë strukturash si Departamenti, Deakanati, Komisioni i Zhvillimit të Kurikulës, strukturave të sigurimit të cilësisë dhe Senatit Akademik.

<p>dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Departamenti është njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e programit të studimit që ofron si dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve. Departamenti është struktura që inicion proceset e përmirësimit të programit mësimor duke i propozuar Dekanatit ndryshimet përkatëse. Departamenti mund të kërkojë rishikim të programeve mësimore dhe kurikulave në baza të nevojave dhe treguesve akademikë cilat trajtohen në vijim nga strukturat e sigurimit të cilësisë. Në kuadrin e mbikqyrjes së programeve të studimit institucioni ka përdorur një sërë metosh, përfshirë edhe feedbackun që merret nga studentët dhe anketimet e Alumni. Këto anketime i referohen vlerësimeve të studentëve edhe në lidhje me kurikulën e programit, performancën e stafit, teknologjive dhe formave të mësimdhënies si dhe infrastrukturës në funksion të programit të studimit. Gjetjet dhe konkluzionet që rezultojnë nga këto sondazhe u referohen Departamenteve përkatëse për marrjen e masave konkrete për përmirësimin e programeve të studimit të ofruara.</p> <p><i>Evidenca 1;</i></p> <p><i>Evidenca 9;</i></p> <p><i>Evidenca 27;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 30;</i></p> <p><i>Evidenca 101 "Formular Propozimi për Ndryshimin e Kurrikulës";</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Rezultatet që rjedhin nga proceset e vlerësimit dhe mbikqyrjes së programeve të studimit dhe cilësisë në tërësi, janë objekt i raporteve të strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Në këto raporte pasqyrohen rezulate e vlerësimit, shembujt e praktikave më të mira si dhe adresimi i mangësive të konstatuara dhe masat për përmirësimin e tyre. Këto raporte shërbejnë për hartimin e planeve të veprimit dhe ndërmarjen e masave konkrete që i referohen përmirësimit të komponentëve të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca nr. 27;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 28;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 73 "Raporti vjetor I Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë";</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në kuadrin e vlerësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit, institucioni ka përdorur një sërë metodash dhe instrumentash të drejtpërdrejta. Këto metoda janë zbatuar kryesisht në nivel Departamenti si njësi përgjegjëse bazë për zbatimin e programit të studimit. Metodatat i referohen kryesisht vlerësimit të mësimdhënies si dhe vlerësimit të të nxënit nëpërmjet një sërë formash testimi të rezultateve të studentëve. Metodatat e drejtpërdrejta të vlerësimit të të nxënit janë pjesë përbërëse dhe detajohen në programet mësimore të lëndëve. Pjesë e sistemit të vlerësimit të të nxënit dhe rezultateve të studentëve janë pjesëmarrja në veprimtarinë mësimore, testimet parake dhe përfundimtare, si dhe vlerësimit të detyrave të kursit dhe projekteve studimore si dhe vlerësimi i pjesëmarrjes në aktivitete jashtëshkollore. Për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, institucioni gjithashtu përdor një sërë metodash në kuadrin e vlerësimit të cilësisë, si sondazhet e studentëve, vlerësimi i punës nga Departamenti, vëzhgimi i zhvillimit të mësimin në auditor për personelin akademik të kategorisë Asistent Lektor.</p> <p><i>Evidenca nr. 4;</i> <i>Evidenca nr.13;</i> <i>Evidenca nr.35;</i> <i>Evidenca nr. 78;</i> <i>Evidenca nr.119 "Formular mbi vlerësimin e performancë së asiten pedagogëve";</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e</p>	<p>Institucioni ka krijuar mekanizmat e duhur si dhe ka hartuar dhe vënë në përdorim një sërë metodash të tërthorta të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, të gjitha programet e studimit të ofruara i nështrohen procesit të vlerësimit të brendshëm nëpërmjet të cilit strukturat përgjegjëse në zbatimin e programit vlerësojnë cilësinë e programit dhe performancën e veprimtarisë në zbatimin e tij.</p> <p>Vlerësimit të brendshëm i nështrohen të gjitha strukturat akademike dhe ato administrative. Në kuadër të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, institucioni zhvillon sondazhe mbi aspektet që lidhen me cilësinë e programit dhe funksionimin e institucionit. Nëpërmjet sondazheve të studentëve vlerësohet performanca e pedagogëve të lëndës, infrastruktura dhe</p>

<p>dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>shërbimet e ofruara nga institucioni. Sondazhe të tilla akryhen edhe me studentët Alumini.</p> <p>Bazuar në vlerësimet dhe sugjerimet që rezultojnë nga instrumentat e tërthorta të vlerësimit të cilësisë hartohen plane konkrete veprimi që i referohen përmirësimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca nr. 9;</i></p> <p><i>Evidenca nr.31;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 95;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 96, "Sondazh I vlerësimit të kënaqësisë së kompanisë";</i></p> <p><i>Evidenca 104, Evidenca 107;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Universiteti "Epoka" ka vënë në zbatim politika të qarta si dhe procedura të vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive. Në kuadrin e vlerësimit të cilësisë, Institucion ka përdorur dhe zbaton metodologji vlerësimi të mbarëvajtjes dhe cilësisë të programeve të studimit.</i></p> <p><i>Për vlerësimin e cilësisë së programve të studimit janë përdorur një sërë metodash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në përshtatje me natyrën dhe specifikat e programeve.</i></p> <p><i>Metoda të tilla janë përdorur edhe për vlerësimin e cilësisë së Programit të Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë në Drejtësi. Nëpërmjet këtyre mekanizmave Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programin e studimeve mbi rëndësinë e sigurimit të cilësisë edhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni mundëson angazhimin e një sërë aktorësh në procesin e vlerësimit të cilësisë si dhe aksesimin e kontributeve të gjithsecilit në këtë proces. Universiteti “Epoka” ka ngritur një sistem efikas me një sërë strukturash të brendshme të sigurimit të cilësisë. Përbërja e këtyre strukturave mundëson pjesëmarrjen në proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, të personelit akademik, ndihmës administrativ si dhe studentëve.</p> <p>Gjithashtu pjesëmarrja e aktorëve të brendshëm mundësohet edhe nëpërmjet mekanizmave e metodave të tërthorta të vlerësimit të cilësisë ku mundësohet përfshirja dhe opinion i tyre mbi cilësinë e programeve të studimit. Për sa i takon aktorëve të jashtëm, roli i tyre mundësohet nëpërmjet përfaqësimit në strukturat e sigurimit të cilësisë si dhe sistemit të bashkëpunimit institucional e partneritetit me institucione publike e private vendase e ndërkombëtare. Përfshirja e një eksperti të jashtëm në përbërjen e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë është një element i rëndësishëm në këtë drejtim. Nëpërmjet sondazheve e aktiviteteve Alumini mundësohet edhe ndikimi i studentëve Alumni në përmirësimin e vazhduar të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i> <i>Evidenca nr. 9;</i> <i>Evidenca nr. 26;</i> <i>Evidenca nr. 44;</i> <i>Evidenca nr. 69, Evidenca nr.73;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Nëpërmjet politikave të sigurimit të cilësisë institucioni përcakton detyra e përgjegjësi konkrete për të gjithë aktorët e angazhuar në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Aktet e brendshme të institucionit kanë përcaktuar detyrat dhe kompetencat e stafit akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ në këtë proces. Strukturat e sigurimit të cilësisë mbikqyrin angazhimin dhe bashkëpunimin e të gjithë aktorëve në procesin e sigurimit të cilësisë si dhe ushtrimin e këtyre detyrave. Përbërja e strukturave të sigurimit të cilësisë mundëson pjesëmarrjen e studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet përfaqësimit në organe të tilla si Komisioni i përhershëm i Sigurimit të Cilësisë apo Senati Akademik.</p> <p><i>Evidenca nr.1;</i></p>

	<p><i>Evidenca nr. 73;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 75;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 111;</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e strukturave akademike, ndihmës-akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të cilësisë është pjesë e strategjive institucionale. Aktet regullatore të brendshme parashikojnë rregullime mbi rolin e Departamentit të Drejtësisë si njësi përgjegjëse kryesore për këtë program studimi, si dhe atë të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ dhe studentëve në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Departamenti i Drejtësisë si njësi bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit është angazhuar në një sërë formash në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së këtij programi.</p> <p>Aspektet që lidhen me cilësinë e programit të studimit janë pjesë e Raporteve Vjetore të Punës dhe veprimtarisë së Departamentit. Në këto raporte ka edhe parashikime mbi pjesëmarrjen dhe performancën e studentëve në secilën nga lëndët e programit mësimor të cilat ndihmojnë në nxjerrjen e konkluzioneve mbi cilësinë e programit të studimit dhe nevojat për përmirësim.</p> <p>Stafi akademik i këtij programi studimi çdo vit akademik rishikon syllabusat e lëndëve në lidhje me temat dhe literaturën me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit mësimor. Angazhimi në punë administrative i stafit akademik nxit pjesëmarrjen aktive në procesin e administrimit të programit të studimit dhe vlerësimin e cilësisë së tij. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit përfshin edhe strukturat administrative që ushtrojnë veprimtari në administrimin e këtij programi.</p> <p><i>Evidenca nr. 12;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 74;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 97;</i></p> <p><i>Evidenca 3 (dokumentacioni shtesë), Evidenca 4 (dokumentacioni shtesë);</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo</p>	<p>Përfshirja e të gjithë aktorëve të brendshëm në procesin e vlerësimit të cilësisë mundësohet në përputhje me parimet e integritetit akademik, barazisë dhe ndalimit të diskriminimit. Për këtë qëllim aktet regullatore të brendshme parashikojnë një sërë rregullimesh mbi procedurat e përfshirjes së stafit akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ që mundësojnë respektimin</p>

<p>pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>e parimit të barazisë dhe integritetit akademik duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie.</p> <p>Procedura të tilla janë ato që i referohen kritereve të përzgjedhjes në strukturat përgjegjëse të vlerësimit të cilësisë, përcaktimi i kompetencave të qarta për secilin nga aktorët e përfshirë, parimi i kolegjalitetit në vendimmarje, të drejtën e shprehjes së mendimit pa asnjë diskriminim si dhe çdo masë tjetër që eviton anshmërinë dhe konfliktin e interesit në procesin e vendimmarjes. <i>Evidenca nr. 1;</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Nëpërmjet politikave të institucionit mundësohet angazhimi i aktorëve të jashtëm në mbarëvajtjen e programit të studimit si dhe aksesimi i kontributeve të tyre në procesin e vlerësimit të cilësisë së këtij programi. Pjesë e stafit akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies në Programin e Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë në Drejtësi është edhe stafi akademik me kontratë. Anëtarët e këtij stafi kanë kualifikimin akademik dhe eksperiencën profesionale për të kontribuar në procesin e vlerësimit të cilësisë së programit. Përfaqësues të këtij stafi ishin gjithashtu present në takimin e GVJ me stafin akademik në kuadrin e procesit të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit. Në strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë (Komisioni i përhershëm për Sigurimin e Cilësisë) është mundësuar përfaqësimi i ekspertëve të jashtëm.</p> <p>Marëveshjet e partneritetit të lidhura në nivel institucional si dhe pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare në kuadrin e tyre, ka mundësuar ekspertizë edhe në proceset që i referohen sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca nr. 1;</i> <i>Evidenca nr. 26;</i> <i>Evidenca nr. 63;</i> <i>Evidenca nr. 96;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</i></p> <p><i>Nëpërmjet politikave të tij të sigurimit të cilësisë, Universiteti Epoka mundëson angazhimin e një sërë aktorësh në procesin e vlerësimit të cilësisë si dhe aksesimin e kontributeve të gjithsecilit në këtë proces. Në aktet e tij të brendshme institucioni rregullon</i></p>

	<p><i>angazhimin e gjithsecilit nëpërmjet përcaktimit të detyrave e përgjegjësi konkrete për të gjithë aktorët e angazhuar.</i></p> <p><i>Përfshirja e aktorëve të brendshëm në procesin e vlerësimit të cilësisë realizohet në përputhje me parimet e integritetit akademik, barazisë dhe ndalimit të diskriminimit. Pjesë përbërëse e proceseve të vlerësimit janë edhe bashkëpunëtorët e jashtëm të cilët me ekspertizën profesionale kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Univeristeti “Epoka” i pasqyron politikat, parimet si dhe procedurat që zbatohen në procesin e procesit të vlerësimit të cilësisë në strategjitë zhvillimore, manualët e cilësisë dhe aktet të tjera rregullatore. Bazuar në parimin e transparencës këto akte dhe dokumenta strategjikë bëhen publike për studentët dhe gjithë të interesuarit nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit. Njëkohësisht, ato u bëhen të njohura departamenteve apo strukturave drejtuese nëpërmjet sistemit të brendshëm të komunikimit. Studentët marrin pjesë në proceset e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet përfaqësimit në strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Ata informohen nga pedagogët gjatë procesit akademik mbi aspekte të vlerësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit. Studentët mund të aksesojnë informacion të detajuar nëpërmjet guidave e udhëzuesve që institucioni harton për studentët të publikuara në faqen web të institucionit.</p> <p><i>Evidenca nr 43;</i></p> <p><i>Evidenca nr.44;</i></p> <p><i>Evidenca nr.58;</i></p>

	<p><i>Evidenca nr.75;</i></p> <p><i>Evidenca nr.78;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni ka një politikë si dhe procedura të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore mbi publikimin e materialeve që i referohen veprimtarisë institucionale. Publikimi bëhet në përputhje me rregullat e etikës akademike, parashikimet e Statutit, rregulloreve të brendshme dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë qëllim në nivel institucional janë ngritur dhe funksionojnë edhe struktura të dedikuara si Zyra e Medias dhe Marëdhëniet me Publikun.</p> <p><i>Evidenca 1;</i></p> <p><i>Evidenca 79;</i></p> <p><i>Evidenca nr.80;</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në kaudrin e proceseve të vlerësimit të brendshëm hartohen raporte vjetore në nivel institucional. Në këto raporte pasqyrohet vlerësimi mbi rezultatet e aritura nga institucioni për veprimtarinë akademike si dhe adresohen rekomandimet mbi mangësitë e evidentuara. Këto rekomandime u adresohen strukturave të caktuara me sigurimin e cilësisë të cilat, në kuadrin e strategjive për përmirësimin e cilësisë, hartojnë edhe plane konkrete për masat që do të ndërmeren me qëllim arritjen e objektivave që i referohen cilësisë.</p> <p>Departamentet gjithashtu hartojnë plane veprimi që i referohen përmirësimit të programit të studimit sipas formularëve tip të hartuar nga strukturat e sigurimit të cilësisë. Përfundimet që rezultojnë nga anketimet mbi vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies pasqyrohen gjithashtu në plane konkrete veprimi që i referohen masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca nr. 27;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 30;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 73;</i></p> <p><i>Evidenca RVB;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të</p>	<p>Në përputhje me aktet e tij rregullatore, institucioni vlerëson efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive të ndërmara në kuadër të vlerësimit të cilësisë të programit të studimit. Vlerësimi i efektivitetit të veprimtarive të realizuara në kuadrin e vlerësimit</p>

<p>cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>të cilësisë realizohet nëpërmjet një sërë procedurash e mekanizmash si raporte, anketime, plane veprimi etj. Në këtë proces synohet të përfshihen një numër sa më i gjerë strukturash nga niveli institucional deri në nivelin e njësive bazë.</p> <p>Si të tilla janë strukturat e dedikuara ndaj procesit të vlerësimit të cilësisë si KSBC, Zyra e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë apo Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulës. Struktura të tjera në nivel institucional si, Senati Akademik luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm. Një kontribut me vlerë në vlerësimin e efektivitetit të veprimtarive të realizuara në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programit të studimit luan Departamenti i Drejtësisë.</p> <p><i>Evidenca nr.73;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 93 (tabela 24);</i></p> <p><i>Evidenca nr.110;</i></p> <p><i>Evidenca nr.111;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Infromimi i studentëve dhe stafit akademik mbi proceset e sigurimit të cilësisë mundësohet së pari për shkak të shkallës së gjerë të përfshirjes dhe përfaqësimit në strukturat institucionale me përgjegjësi të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë si KSBC apo Senatit Akademik. Gjithashtu përfaqësues të stafit akademik janë anëtarë të strukturave të tjera të vlerësimit të cilësisë si Bordi i Provimeve, Bordi i Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Përmirësimit të Cilësisë etj.</p> <p>Institucioni ka krijuar një sërë metodash e mjetesh për informimin e të gjithë të interesuarve mbi proceset e sigurimit të cilësisë. Për studentët dhe stafin akademik janë hartura udhëzues e manuale të veçanta mbi strukturat e mekanizmat e cilësisë. Informimi realizohet edhe nëpërmjet publikimit të raporteve të vlerësimit të cilësisë dhe informacioneve në faqen zyrtare të institucionit. Rritja e ndërgjegjësimit të studentëve mbi rëndësinë e përfshirjes në sigurimin e cilësisë të programit të studimi mundësohet edhe nëpërmjet angazhimit të studentëve në Këshillat Studentorë apo Klubet Studentore ku studentët marrin pjesë aktive.</p> <p><i>Evidenca nr. 16;</i></p> <p><i>Evidenca nr.27;</i></p> <p><i>Evidenca nr.43;</i></p>

	Evidenca nr.57; Evidenca nr. 93, tabela 24;			
Konkluzione	<p>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ evidenton gjetjet si më poshtë:</p> <p><i>Politikat, parimet si dhe veprimtaritë që zbatohen në procesin e vlerësimit të cilësisë në Universitetin “Epoka” janë të hapura dhe transparente. Ato bëhen publike për studentët, stafin akademik dhe gjithë të interesuarit bazuar në parimin e transparencës nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit apo komunikimeve zyrtare.</i></p> <p><i>Institucioni ka një politikë si dhe procedura të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore në lidhje me publikimin e materialeve që i referohen veprimtarisë institucionale në përputhje me rregullat e etikës akademike si dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Në përputhje me aktet e tij rregullatore, institucioni vlerëson efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive të ndërmara në kuadër të vlerësimit të cilësisë të programit të studimit si dhe informon aktorët e përfshirë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Program i Integruar i Ciklit të Dytë në “Drejtësi”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i Studimit të Integruar i Ciklit të Dytë në “Drejtësi” ofron për studentët njohuri të thelluara mbi të drejtën e brendshme dhe atë ndërkombëtare, duke synuar ndërkombëtarizimin e këtij programi, si një ndër prioritetet strategjike të institucionit, që lidhet me ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor;
2. Institucioni, përmes zyrave përkatëse (Zyra e Karrierës dhe Alumni), për cdo program studimi, organizon dhe realizon sondazhe në lidhje me mundësinë e punësimit të studentëve dhe aplikimit të njohurive të përftuara gjatë studimeve në tregun e punës. “Zyra e Karrierës dhe Alumni” organizon sondazhe me të diplomuarit dhe me kompanitë ku të diplomuarit janë të punësuar;
3. Institucioni përmes njësive dhe zyrave përkatëse ofron për stafin akademik trajnime të vazhdueshme në lidhje me përdorimin dhe aplikimin e metodave interaktive dhe të dixhitalizuara të mësimdhënies, duke mundësuar për studentët një përftimim sa më të mirë të njohurive në auditor;
4. Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” mundëson për stafin akademik dhe studentët pjesëmarrjen në aktivitetet kërkimore, e cila lidhet me aktivitetet e organizuara nga strukturat akademike të institucionit dhe Departamentit të Drejtësisë (si njësi bazë për këtë program studimi);
5. Institucioni përmes akteve të brendshme dhe njësive/zyrave përkatëse siguron monitorimin dhe zbatimin e procedurave të vlerësimit të dijeve të studentëve, duke garantuar anonimatën dhe mundësuar transparencën e këtij procesi;
6. Institucioni ka anagazhuar personel ndihmës akademik të përshtatshëm, i cili ndihmon dhe mbështet realizimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimit shkencor në këtë program studimi, duke mundësuar përmes akteve normative rregullime në lidhje me kriteret dhe procedurat e punësimit, me qëllim rekrutimin e personelit të kualifikuar dhe garantimin e qëndrueshmërisë së stafit;
7. Departamenti disponon burimet e nevojshme njerëzore për të mundësuar mbështetjen dhe asistencën ndaj studentëve në veprimtaritë në funksion të programit të studimit, përfshirë edhe praktikën profesionale;
8. Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” zhvillohet në një infrastrukturë të përshtatshme dhe mjedise mësimore të paisura me mjetet e nevojshme teknologjike dhe didaktike për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, duke mundësuar për studentët dhe stafin akademik të këtij programi qasje në të gjitha mjediset dhe mjetet teknologjike e didaktike që i shërbejnë objektivave formues të programit;

9. Institucioni administron një sistem efikas të menaxhimit, i cili nëpërmjet platformave të dedikuara për shkëmbimin e informacionit, mundëson administrimin dhe monitorimin në kohë reale të informacionit në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor në këtë program studimi;
10. Në përputhje me kriteret e legjislacionit në fuqi në fushën e arsimit të lartë, Universiteti Epoka ka hartuar një bazë të gjerë rregullatore, me të cilën rregullohen të gjitha spektet e jetës universitare ku parashikohen në mënyrë të detajuar procedurat që mbulojnë të gjithë ciklet e studimit perfshire dhe Programin e Integruar i Ciklit të Dytë në “Drejtësi”;

b. Pika të dobta:

1. Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë në të cilin ofrohet ky program studimi, nuk realizon përmes raportit vjetor një analizë mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit; (*Standarti I.3, Kriteri 4.*)
2. Angazhimi në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi edhe të stafit akademik me Msc, ndërkohë që kërkohet që stafi akademik të ketë të paktën gradë shkencore (Dr), sipas parashikimit të nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet niveli i kualifikimit akademik; (*Standarti IV.1, Kriteri 1.*)
3. Për 3 vitet e fundit akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi *nuk* është realizuar në masën 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, në ndryshim nga parashikimet e akteve nënligjore në fuqi që i referohen realizimit të kesaj ngarkese mësimore; (*Standarti IV.1, Kriteri 2*)

Rekomandime

1. GVJ rekomandon, që pjesë e raporti vjetor të njësisë bazë (Departamentit të Drejtësisë) të jetë dhe vlerësimi mbi marrëveshjet e bashkëpunimit, të cilat janë në funksion të këtij programi studimi. Përfshirja në raportin vjetor të njësisë bazë të komponentit që lidhet me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit apo dhe mos realizimin e objektivave që synohen nga njësi në lidhje me këto marrëveshje do të ndihmonte departamentin në përmbushjen e objektivave akademike;
2. GVJ rekomandon që njësi bazë (Departamenti i Drejtësisë), duhet të lidhë marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave mësimore dhe shkëmbim të ekspertizës akademike dhe profesionale edhe me institucione të tjerë në fushën e drejtësisë. Kjo do të mundësonte dhe një shkëmbim reciprociteti me institucionet publike dhe private, të cilat veprojnë dhe kontribuojnë në fushën e drejtësisë dhe do të shtonte gjithashtu dhe kontaktet institucionale, të cilat do ta lidhnin edhe më shumë këtë program studimi me tregun e punës;

3. GVJ rekomandon që të meren masat e nevojshme për të mundësuar që personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në realizimin e këtij program studimi të ketë të paktën gradën shkencore Dr. në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik për stafin akademik të përfshirë në procesin e mësimdhënies në programin e integruar të ciklit të dytë;
4. GVJ rekomandon që Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë përgjegjëse të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis PAE dhe PAK në këtë program studimi në mënyrë që mbulimi i ngarkesës nga PAE i angazhuar në procesin e mësimdhënies të përputhet tërësisht me standartet e kërkuara që i referohen mbulimit të ngarkesës mësimore në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi (në masën 70%);
5. GVJ sugjeron pasurimin e mëtejshëm të fondit fizik të literaturës që i referohet këtij programi studimi me literaturë bashëkohore në gjuhën shqipe në funksion të dijeve mbi të drejtën e brendshme që synohen t'i jepen studenteve për qëllimet akademike të programit;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Integrated Second Level Program in "Justice" "

a. Strengths and affirmations:

1. The Integrated Study Program of the Second Cycle in "Law" offers students in-depth knowledge on domestic and international law, aiming at the internationalization of this program, as one of the institution's strategic priorities, related to internationalization and scientific research;
2. The institution, through the relevant offices (Career and Alumni Office), for each study program, organizes and carries out surveys regarding the possibility of employing students and applying the knowledge gained during studies in the labor market. "Career and Alumni Office" organizes surveys with graduates and companies where graduates are employed;
3. The institution, through the relevant units and offices, offers the academic staff continuous training regarding the use and application of interactive and digitized teaching methods, enabling students to obtain the best possible knowledge in the classroom;
4. The Integrated Program of the Second Cycle of studies in "Law" enables academic staff and students to participate in research activities, which is related to the activities organized by the academic structures of the institution and the Department of Law (as the basic unit for this study program);
5. The institution, through internal acts and units/offices related to monitoring the process of evaluating students' knowledge, guarantees anonymity and transparency in this process;



6. The institution has hired suitable academic assistant personnel, who help and support the realization of the teaching activity and scientific research in this study program, enabling through normative acts regulations regarding employment criteria and procedures, in order to recruit qualified personnel and guaranteeing staff stability;
7. The department has the necessary human resources to enable support and assistance to students in activities related to the study program, including professional practice;
8. The Integrated Program of the Second Cycle of studies in "Law" is carried out in an appropriate infrastructure as well as learning environments equipped with the necessary technological and didactic tools for the development of teaching activities, enabling the students and academic staff of this program access to all technological and didactic facilities and equipment;
9. The institution administers an efficient management system, which, through platforms dedicated to information exchange, enables real-time administration and monitoring of information in function of the progress of the learning process in this study program;
10. In accordance with the criteria of the legislation in force in the field of higher education, Epoka University has drawn up a broad regulatory basis, which regulates all aspects of university life, where the procedures covering all cycles of study including the Integrated Program of the Second Cycle in "Law";

b. Weaknesses:

1. The Department of Justice (as the basic unit in which this study program is offered) does not carry out an analysis of the benefits of cooperation agreements through the annual report; (*Standard I.3, Criterion 4.*)
2. The engagement in the teaching process in this study program of the academic staff with the level of Msc studies, while it is required that the academic staff should have at least the scientific degree (Phd), according to the provisions of article 59/6 of Law no. 80/2015 where the level of academic qualification is determined; (*Standard IV.1, Criterion 1.*)
3. During the last 3 academic years, the teaching load for this study program has not been carried out to the extent of 70% by the full-time academic staff, contrary to the provisions of the by-laws in force that refer to the teaching load; (*Standard IV.1, Criterion 2.*)

Recommendation

1. GVJ recommends that part of the annual report of the basic unit (Department of Justice) be the evaluation of cooperation agreements, which are in function of this study program. The inclusion in the annual report of the basic unit of the component related to the benefits from cooperation agreements or the non-realization of the objectives aimed by the unit in relation to these agreements would help the department in fulfilling its academic objectives;



2. GVJ recommends that the basic unit (Department of Justice) should conclude other cooperation agreements for the development of teaching practices and exchange of academic and professional expertise with other institutions in the field of justice. This would enable an exchange of reciprocity with public and private institutions, which operate and contribute in the field of justice and would also increase institutional contacts, which would connect this study program with the labor market even more;
3. GVJ recommends that the necessary measures be taken for the academic staff engaged in the realization of this study program to have the appropriate scientific qualification, in order to fulfill the legal requirements in force, for the appropriate level of academic qualification for the academic staff involved in the teaching process in the integrated program of the second cycle of studies;
4. GVJ recommends that the Department of Justice, as the basic responsible unit, review the distribution of the teaching load between the effective staff and those with contracts in this study program, so that the coverage of the teaching load by the effective staff engaged in the teaching process is fully matched with the required standards that refer to the coverage of the teaching load in accordance with the legal framework in force (to the extent of 70%);
5. GVJ suggests the further enrichment of the physical fund of literature that refers to this study program with contemporary literature in the Albanian language in function of the knowledge on domestic law that is intended to be given to students for the academic purposes of the program;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X